



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.11.2021)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarës {...}, relator z. Erjon Muharremaj.<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 16:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Naureda Llagami</i></b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>2. Maksim Qoku</i></b>     | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>3. Medi Bici</i></b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>4. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Dritan Hallunaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>6. Ilir Toska</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>8. Marçela Shehu</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>1</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta në rendin e ditës.

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje për arsye familjare anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brunilda Kadi**, ndaj çështjet e parashikuara në rendin e ditës ku relatores është znj. Kadi, dalin nga rendi i ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**
- 6. {...}, magjistrate.**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarës {...}, relator z. Erjon Muharremaj.

**Naureda Llagami:** Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 23 nëntor 2021, ora 12:00.

Siç jeni në dijeni, sot në rendin e ditës janë 15 çështje.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët, përveç zonjës Kadi e cila për shkak të një fatkeqësie familjare e ka të pamundur që të jetë në mbledhjen e sotshme. Për më tepër, çështjet për të cilat zonja Kadi është relatores, do të shtyhen në mbledhjen e radhës. Konkretisht bëhet fjalë për:

Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...} (çështja nr. 8); Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...} (çështja nr. 9); Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, për gjyqtarin {...}.

Kalojmë pa humbur kohë në çështjen e parë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarës {...}. Relator është z. Erjon Muharremaj.

Ftojme zonjën {...} duke qenë se ka kërkuar që të dëgjohet nga Këshilli.

*(Futet në sallën e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}.)*

**Naureda Llagami:** Përshëndetje znj. {...}!

Faleminderit që keni ardhur në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku do të shqyrtohen dy raportet e vlerësimit tuaj etik dhe profesional, ai i nivelit të vlerësimit (gradimit) 2013-2016 dhe raporti i vlerësimit për vitin 2019.

Për procedurë, fjala fillimisht do t'i jepet relatorit për sa i përket një prezantimi të shkurtër të raportit dhe gjetjeve të vlerësimit tuaj. Më pas ju keni mundësi të bëni prezantimin dhe komentet nëse ju keni, përveç atyre që keni përcjellë me shkrim dhe që nga ana e Këshillit është vënë në dijeni mbi përmbajtjen. Më pas do vazhdoni jashtë për të lejuar Këshillin lidhur me vlerësimin dhe marrjen e vendimit.

Pa humbur kohë fjalën ia jap zotit Muharremaj.

**Erjon Muharremaj:** Të gjithë jeni njohur me projekt-aktet e vlerësimit për gjyqtaren {...}.

Ndaj projekt-akteve gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet e saj dhe prandaj ka kërkuar të dëgjohet sot në seancën dëgjimore. Kështu që unë do të ndalem në mënyrë të posaçme tek ata tregues për të cilët gjyqtarja ka pasur kundërshtime, për të sqaruar edhe arsyen e propozimit që është bërë.

Duke filluar me “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, sa i përket “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, propozimi është që shkalla e aftësisë është “shumë e lartë”, pikëzimi me 25 pikë.

Në lidhje me treguesin e “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” në projektraport propozimi është bërë që gjyqtarja {...} të vlerësohet në nivelin “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë, pasi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material penal, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes, dhe vetëm në një rast ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Nuk evidentohet një analizë e veçantë e normave të ligjit, një analizë e pavarur e fakteve penal objekt shqyrtimi. Gjyqtarja aplikon dhe referon normën ligjore mbi faktet e çështjes duke bërë zbërthimin e saj sipas elementëve të veprës penale në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim dhe në vijim nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet e saj, duke parashtruar (po citoj):

“...Së pari, mendoj dhe gjykoj se është një konkluzion i cili nuk qëndron në koherencë me të gjitha gjetjet, konstatimet, argumentet, analizat dhe vlerësimet e hollësishme bërë punës arsyetuese të gjyqtares përgjatë gjithë materialit/eve të sipërcituara, të pasqyruara edhe në vetë projektraportin që më është komunikuar në kuadër të këtij vlerësimi etik dhe profesional.

Së dyti, citimi i bërë në faqen Nr. 39 (paragrafi “Konkluzione”) në projektraport, është i pambështetur në asnjë normë apo dispozitë ligjore. Nuk arrihet të argumentohet se ku konsiston, apo ku do të konsistonte “analiza e veçantë e normave ligjore, në aspektin teorik dhe të pavarur nga fakti penal objekt gjykimi”. Nuk argumentohet në këtë “konkluzion” se cila është dispozita ligjore, procedurale e cila e detyron gjyqtarin që gjatë arsytimit ligjor të një vendimi, duhet të përfshijë domosdoshmërisht në të, një trajtim të natyrës absolutisht teorik apo doktrinal të dispozitës/ave ligjore të aplikuara, në kuptimin abstrakt të saj.

Së treti, nuk analizohet cila ka qenë nevoja në rastin konkret, që gjyqtarja do të duhej që në arsyetimin ligjor të saj, në kuadër të një gjykimi të shkurtuar, pa asnjë debat gjyqësor, pa asnjë problematikë të natyrës materiale apo procedurale ligjore, teksa të gjitha faktet, provat, rrethanat konkrete dhe kualifikimi ligjor i veprës penale, rezultojnë të jenë gjithë pranuar pa asnjë lloj kontestimi nga asnjë prej palëve, dhe as nuk është konstatuar nga vetë gjykata ndonjë detaj i nevojshëm i cili do të kishte përbërë shkak procedural për t'u marrë në analizë të hollësishme dhe të posaçme nga vetë gjyqtarja (kryesisht), të kryente gjithashtu edhe një trajtim doktrinal të hollësishëm të një dispozite materiale penale (në kuadër të neneve 137, 199, 291 të Kodit Penal).

Së katërti, ndonëse rubrika e vlerësuar titullohet: “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, (pasi qëllimi final i veprimtarisë së punës së një gjyqtari është zgjidhja e duhur dhe e drejtë e çështjes, në zbatimin dhe interpretimin e duhur të ligjit, në raport me rrethanat e faktit dhe në tërësi me çështjen në gjykim), gjyqtarës i kërkohet apo i vihet në dukje fakti që mungon “analiza e veçantë e normave ligjore, në aspektin teorik dhe të pavarur nga fakti penal objekt gjykimi”!!!” – këtu përfundon citimi.

Pavarësisht natyrës së çështjes, interpretimi i normës juridike në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative që gjejnë zbatim në normat konkrete, në thelb rrisin vlerën e një vendimi gjyqësor në funksion të të kuptuarit të tij prej palëve apo kujtdo që e lexon atë, edhe nëse nuk është profesionist i ligjit. Neni 383 i Kodit të Procedurës Penale i parashtruar nga gjyqtarja ka lidhje me strukturën e vendimit për të cilën gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht në treguesin 1Bb “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”.

Në Metodologjinë e Pikëzimit për këtë tregues përcaktohet se vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të interpretuar ligjin e identifikuar dhe arsyetimin e tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimit.

Në kushtet kur në disa prej vendimeve të analizuara, nuk evidentohet një analizë e veçantë e normave të ligjit, (teorike dhe e pavarur nga fakti penal objekt shqyrtimi), por gjyqtarja referon dhe aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, e në vijim nxjerr

konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit, në cilësinë e relatorit, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraportin e vlerësimit për vlerësimin me 20 pikë.

Në lidhje me “Qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e vendimit”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi me 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 10 pikë.

Në lidhje me treguesin e “Cilësisë së analizës dhe e argumentimit logjik”, në projektraport propozimi është që të vlerësohet në nivelin “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë, kjo pasi në pjesën më të madhe të vendimeve të analizuara (kryesisht atyre të përzgjedhura me short), konstatohet se gjyqtarja nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur pjesës së analizës së ligjit mbi provat. Ajo që konstatohet lehtësisht në mënyrën e të shkruarit të gjyqtarës është arritja e konkluzionit mbi zgjidhjen e çështjes duke u bazuar vetëm në faktin dhe pa bërë një analizë të provave, e në mënyrë të veçantë, pa bërë një analizë të mbështetur në prova të anës objektive të veprës penale.

Gjithashtu, konstatohet që edhe kur bëhet analiza e provave, ajo bëhet e shkëputur nga analiza juridike e elementëve të veprës penale, pa kaluar tek ligji i zbatueshëm relevant dhe analiza e këtyre elementëve të veprës penale. Konkretisht, në një prej vendimeve penale burim vlerësimi në vendimin nr. 2184, datë 17.06.2015, konstatohet se vetëm në pjesën e përshkrimit të rrethanave të çështjes, nga ana e gjyqtarës është bërë analiza e provave, ndërkohë që ka edhe një paqartësi në këtë vendim, pasi në pjesën e ligjit të zbatueshëm (citimi i nenit 137 të Kodit Penal) nga mënyra se si janë përshkruar dhe analizuar elementët e kësaj figure të veprës penale, duket sikur gjyqtari shkon drejt përcaktimit të përgjegjësisë penale të të pandehurit për këtë vepër penale. Citimi tek objekti se: “Veprimet e kundërligjshme të kryera nga ana e të pandehurit kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar përdorimin dhe administrimin e rregullt të energjisë elektrike si pronë shtetërore”, apo tek ana objektive, duke u shprehur se: “I pandehuri veprën penale e ka kryer me veprime aktive duke lidhur energjinë elektrike”. Gjithë kjo analizë e bërë nga ana e gjykatës nuk përputhet me konkluzionin e arritur dhe të analizuar në pjesën e përshkrimit të rrethanave të faktit në

deklarimin e pafajshëm të të pandehurit. Gjithashtu, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh: Institutit të dënimit apo edhe të alternativave të dënimit duke përcaktuar qëllimin, funksionin e tyre, si dhe kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për zbatimin e tyre, duke i analizuar në mënyrë të detajuar këto kritere në ligj, në përputhje me provat dhe rrethanat në çdo rast gjykimi. Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së çështjes penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë lidhjes shkakësore (të veprimeve dhe mosveprimeve të të pandehurit dhe ardhjes së pasojës së kundërligjshme) dhe kur evidenton mungesë të saj konkludon në deklarimin e pafajshëm të të pandehurit.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar se (citoj):

“Së pari, mendoj dhe gjykoj se, një detaj, apo një vendim i vetëm i marrë në vlerësim, në analizë dhe në shqyrtim si një rast krejtësisht i shkëputur, nuk mund të përbëjë arritjen në një konkluzion të drejtë, objektiv, të plotë dhe të gjithanshëm për të vlerësuar aftësinë e një gjyqtari lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentin logjik në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, për një periudhë kohore (periudha e vlerësimit profesional) 2013 – 2016, ku mesatarisht gjyqtarja rezulton të ketë gjykuar dhe arsyetuar rreth 1.200 çështje penale në total. Shumica e këtyre vendime gjyqësore, janë të gjykuara dhe të arsyetuara brenda një afati më të shkurtër se standardi minimal (kohor) i përcaktuar në ligj, janë vendime gjyqësore të arsyetuara me cilësi dhe përgjegjshmëri tepër të lartë profesionale, janë vendime ose të paankimuara, ose të lëna në fuqi nga gjykatat më të larta, si vendime të bazuara e të mbështetura qartazi në prova, në fakte, në ligj, dhe sigurisht në argumentin dhe analizën e duhur ligjore si dhe atë logjike.

Së dyti, referuar objeksioneve të pasqyruara në paragrafin e parafundit dhe të fundit, në faqen nr. 44 të projektraportit, si dhe në paragrafin e parë të faqes nr. 45 të projektraportit, nuk reflektohet aspak arsyetimi ligjor, analiza dhe argumenti logjik (tepër i qartë, i hollësishëm, analitik, i mbështetur si në prova ashtu edhe në ligj) i përdorur nga gjyqtarja pikërisht edhe në vendimin nr. {...}, datë 17.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i shkruar dhe i arsyetuar në 9 faqe (bashkëngjitur këtij

materiali). Baza ligjore e cituar nga gjykata në faqen nr. 8 të vendimit nr. 2184, datë 17.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (përmbajtja e dispozitës ligjore - neni 137 i Kodit Penal), analiza e 4 elementëve bazë/përbërës të kësaj vepre penale, si dhe citimi përkatës lidhur me anën objektive të kësaj vepre penale, ku gjithashtu rezultoi të jetë shkruar: “I pandehuri veprën penale e ka kryer me veprime aktive duke vjedhur energjinë elektrike”, ka pasur për qëllim në vetvete të parashtrojë përmbajtjen e dispozitës materiale penale, si dhe cilët do të ishin 4 elementët, vërtetimi i pranisë të së cilëve, do të përbënte shkak të ekzistencës së kësaj vepre penale, dhe do ta ngarkonte të pandehurin me këtë përgjegjësi penale. Mjafton të lexosh këtë vendim gjyqësor të arsyetuar në 9 faqe, mendoj se arrihet të kuptohet qartazi që në përmbajtjen e kësaj fjalisë të cituar: “I pandehuri veprën penale e ka kryer me veprime aktive duke vjedhur energjinë elektrike”, bëhet fjalë thjesht dhe vetëm për një gabim material në të shprehur, një lapsus që ka shpëtuar pa dashje në të shkruar, një fjali thjesht e paredaktuar, por kurrsesi nuk ndodhemi përpara një analize kontradiktore në arsyetimin ligjor dhe logjik të vendimit nga ana e gjyqtarës. Gjykata ka pasur për qëllim të theksojë se cilat do të kishin qenë veprimet që në rast të kryerjes së tyre nga ana e të pandehurit do të kishin përbërë anën objektive të kësaj vepre penale. E ritheksoj, mjafton që ky vendim gjyqësor, të lexohet (9 faqe) qoftë edhe një herë të vetme, dhe arrihet të kuptohet qartë, thjesht, lehtë se analiza juridike dhe logjike e përdorur nga gjyqtarja edhe në këtë vendim, është e qartë, e saktë, cilësisht logjike, e bazuar në analizën e plotë të fakteve, provave dhe ligjit në fuqi.”, këtu përfundoj citimin.

Lidhur me kundërshtimin e gjyqtarës, se bëhet fjalë thjesht dhe vetëm për një gabim material në të shprehur, një lapsus që ka shpëtuar pa dashje në të shkruar, një fjali thjesht e paredaktuar, por kurrsesi nuk ndodhemi përpara një analize kontradiktore në arsyetimin ligjor dhe logjik të vendimit nga ana e gjyqtarës, në arsyetimin e vendimit nr. 2184, datë 17.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (është vendim i zgjedhur nga vetë gjyqtarja dhe nuk është përzgjedhur me short), evidentohet se gjyqtarja jo vetëm në analizën e anës objektive, por edhe në analizën e elementëve të tjerë të figurës së veprës penale (objekti, subjekti dhe ana subjektive) analizon duke e veshur me



përgjegjësi penale të pandehur, ndërkohë që konkluzioni i arritur në fund nga ana e gjyqtarës është për deklarimin e pafajshëm të tij.

Një vendim i mirë arsyetuar është ai vendim i cili nuk ka vetëm interpretim të ligjit, por një interpretim të ligjit mbi faktin dhe provat, duke bërë një analizë të hollësishme të provave mbi të cilat mbështet vendimmarrja e gjykatës.

Në kushtet kur pothuajse në shumicën e vendimeve penale burim vlerësimi, të analizuar, konstatohet një mungesë e analizës së provave mbi të cilat gjyqtarja ka arritur në konkluzionin përkatës, si dhe mungesë e procesit logjik nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar e gjykatës, vlerësoj në cilësinë e relatorit se nuk ka vend për të ndryshuar propozimin lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraport, pra për pikëzimin me 20 pikë.

Në total, për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarës” propozohet pikëzimi me 90 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarës”, “Respektimit të afateve ligjore”, shkalla e aftësisë nga 0-10%, pikëzimi maksimal me 15 pikë.

“Plotësimi i standardeve minimale kohore”, shkalla e aftësisë nga 0-10%, pikëzimi maksimal 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” në projektraport është propozuar që të pikëzohet me 4 pikë.

Referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve. Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues është bërë duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe çështjes civile të verifikuar dhe regjistruar gjyqtarës për zvarritje gjykimi, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit. Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori ka rezultuar se:

Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet të kategorisë “Penale krime”, ka rezultuar 3 muaj e 9 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale krime në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet të kategorisë “Penale kundravajtje”, ka rezultuar 1 muaj e 27 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale kundravajtje në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet të kategorisë “Kërkesa penale”, ka rezultuar 4 muaj e 23 ditë, nga 2 muaj që parashikohet si standard minimal për këtë kategori çështjes, pra më e gjatë se standardi minimal kohor.

Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet të kategorisë “Civile themeli”, ka rezultuar 1 vit e 5 muaj nga 6 muaj që parashikohet si standard minimal për këtë kategori çështjes, pra më e gjatë se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve të kësaj kategorie.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara ka rezultuar më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore do të përkonte me një pikëzim prej 3 pikësh.

Nga ana tjetër, rezulton se në aspektin sasior të punës rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 758 çështje, nga të cilat 601 çështje kanë qenë çështje penal themeli (krime dhe kundërvajtje), mesatarisht 200 çështje themeli në vit. (Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje). Mbështetur në po të njëjtën analizë si ajo e treguesit 2.A.b “Plotësimi i standardeve minimale kohore”, në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, por jo në nivelim maksimal të tij pasi koha mesatare që i dedikohet çështje rezulton të jetë kaluar me dyfishin e standardit të përcaktuar për kategoritë e çështjeve “Kërkesa penale” dhe gati me trefishin e kohës për kategoritë e çështjeve “Civile themeli”.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraportin e vlerësimit.

Sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 79.2% që nga pikëpamja matematikore përkon me një pikëzim prej 2 pikësh. Në

kushtet kur gjyqtarja për periudhën e vlerësimit rezulton të ketë gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi, konkretisht: për vitin 2014 ka gjykuar 99% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (199 çështje të gjykuara, nga 100 çështje që është standardi; për vitin 2015 ka gjykuar 117% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (217 çështje të gjykuara, nga 100 çështje që është standardi; për vitin 2016 ka gjykuar 85% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (185 çështje të gjykuara, nga 100 çështje që është standardi. Prandaj, në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja për këtë tregues të vlerësohet dy nivele më lart se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, pra të vlerësohet në nivelin “mbi 87-93%”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja, ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar se (citoj):

“Në kushtet kur, sikurse pasqyrohet edhe në këtë projektraport, nuk disponohen të dhëna statistikore për të përlllogaritur rendimentin, në kushtet kur konstatohet qartazi se gjyqtarja ka përballuar volum shumë të madh në gjykimin e çështjeve të ndryshme dhe komplekse, vlerësimi në nivel pikëzimi, mendoj dhe vlerësoj se duhet të jetë më i lartë se ai i pasqyruar në projektraport.” – përfundoj citimin.

Në kundërshtimet e paraqitura nga gjyqtarja nuk rezulton të jenë paraqitur të dhëna apo shkaqe të tjera që kanë ndikuar në normën e likuidimit të çështjeve, të tilla si kompleksiteti i çështjeve, rritja e papritur të volumit të çështjeve apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës. Gjyqtarja në kundërshtimet e saj, ka parashtruar si shkak volumin e madh të çështjeve të gjykuara, e dhënë kjo e cila në projektraportin e vlerësimit është marrë parasysh, prandaj dhe është propozuar pikëzimi dy nivele më lart se ai që i përket përqindjes së pikëzimit.

Bazuar në këto parashtrësia, në cilësinë e relatorit, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit, duke i qëndruar propozimit për pikëzimin me 6 pikë.

Sa i përket “Kohës mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, pikëzimi maksimal 15 pikë.

“Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, shkalla e aftësisë “1-3 seanca”, pikëzimi maksimal 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” - në projektraportin e vlerësimit për këtë tregues është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet në nivelin “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 16 pikë, për shkak se në dosjet e vëzhguara ka rezultuar se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale, evidentuar në korrektësinë e mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Por nga ana tjetër, evidentohet se 20% e seancave gjyqësore të planifikuara dhe të zhvilluara, gjyqtarja nuk ka respektuar afatin procedural 15-ditor të përcaktuar në nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja, ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar (citoj):

“Referuar përmbajtjes së nenit 342 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi ka parashikuar që në rastet kur, është deklaruar i çelur shqyrtimi gjyqësor për gjykimin e një çështjeje penale, në kuptim të nenit 355 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, gjykata mund ta ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë.

Shtyrja apo caktimi i seancave tej një afati 15-ditor, ka ndodhur vetëm në rastet kur nuk ka qenë i çelur shqyrtimi gjyqësor (neni 355 i Kodit të Procedurës Penale), dhe kjo vetëm për arsye të ngarkesës tepër të madhe në shqyrtimin e një numri të konsiderueshëm të çështjeve nga më të ndryshmet në të njëjtën kohë. Këtu duhet pasur parasysh edhe mundësia e palëve për t’u paraqitur dhe për të qenë të pranishëm në seanca gjyqësore brenda afatit 15-ditor.

Po kështu duhet marrë në konsideratë koha e nevojshme për gjyqtaren në gjykimet e komanduara (nga KLD) në gjykata të tjera nëpër rrethe, koha e nevojshme në frekuentimin e detyrueshëm të trajnimeve vazhduese pranë Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në aktivitete të tjera trajnuese apo institucionale të organizuara nga organe

apo organizata që shtrijnë aktivitetin e tyre në sistemin gjyqësor (OSCE, USAID, EURALIUS, Ministria e Drejtësisë, etj), koha e nevojshme në kryerjen e detyrës së saj dhe pjesëmarrja e saj në mbledhjet e Komisionit të Etikës (të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve në 2 mandate vijuese), të zhvilluara pranë Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, sikurse është vërejtur periudha e shtyrjeve të seancave gjyqësore, e cila nuk ka përkuar me marrjen e lejeve vjetore (gjatë muajit gusht), duhen vlerësuar gjithashtu edhe rrethanat e tjera që mund të kenë ndikuar rast pas rasti në këto shtyrje (tej afatit 15-ditor), sikurse mund të kenë qenë ditët e pushimit zyrtar, festa zyrtare, leje të marra konform ligjit, raporte mjekësore, etj. Pra në çdo rast shkaqet kanë qenë të arsyeshme.

Ngarkesa e madhe në shqyrtimin e çështjeve të ndryshme gjyqësore, është një fakt jo vetëm real, por i ditur dhe i konstatuar gjithashtu në këtë vlerësim etik dhe profesional, rrethanë kjo e pasqyruar në mënyrë eksplicite dhe evidente në këtë projektraport (2013-2016).

Sa i takon konstatimit të mos mbajtjes në sistem “Audio Record” të disa prej seancave gjyqësore të zhvilluara, ky është një fakt i cili lidhet me pamundësinë objektive në kuptim të infrastrukturës që disponon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë – Dhoma Penale në numrin e sallave gjyqësore, në të cilat rezulton i montuar dhe efektiv sistemi i regjistrimit të seancave gjyqësore. Ju sjell në vëmendje faktin se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë – Dhoma Penale, ka vetëm 3 salla në katin e parë (ku zakonisht zhvillohen proceset gjyqësore me të pandehur në gjendje paraburgimi), dhe 3 salla në katin e dytë. Ndërkohë në periudhën 2014 – 2016 në këtë gjykatë ka pasur rreth 26 gjyqtarë, të cilët zhvillonin mesatarisht çdo ditë rreth 10 seanca gjyqësore. Përveç faktit që edhe vetë sistemi audio herë pas here, shfaqte probleme në funksionalitetin e tij, dhe kjo shpesh edhe si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike. Rrethana këto të cilat ekzistojnë edhe aktualisht në punën tonë të përditshme.” – këtu përfundoj citimin.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në vënien në lëvizje të dosjes në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore. Numri i konsiderueshëm i seancave (20% e tyre) të

planifikuara dhe të zhvilluara jashtë afatit procedural 15-ditor, të parashikuar në nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale, është një e dhënë që në këtë rast nuk tregon shkallë shumë të lartë aftësie të gjyqtarës, në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të seancave gjyqësore në përputhje me afatet ligjore.

Lidhur me kundërshtimet për sa i përket konstatimit për mosdokumentimin e seancave gjyqësore nëpërmjet sistemit audio, pavarësisht se referuar Metodologjisë së Pikëzimit është një nga komponentët që merret në vlerësimin e këtij treguesi, në projektraportin e vlerësimit kjo e dhënë nuk ka ndikuar në pikëzimin e gjyqtarës, pikërisht sepse është vlerësuar që mosdokumentimi i seancave gjyqësore nëpërmjet sistemit audio, lidhet me kushtet e punës dhe pamundësinë për t'i zhvilluar ato nëpërmjet sistemit audio, për shkak të infrastrukturës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraportin e vlerësimit, duke pasur parasysh qëndrimin e mbajtur nga Këshilli në vlerësimet e mëparshme.

Sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes”, shkalla e aftësisë është konsideruar “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal me 5 pikë.

Sa i përket “Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes”, propozimi është që shkalla e aftësisë është “shumë e lartë”, pikëzimi maksimal 10 pikë.

Në tërësi, për kriterin e dytë të “Aftësive organizative të gjyqtarës”, propozimi është për pikëzimin me 91 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të tretë të “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, prezumimi është që të gjithë gjyqtarët gëzojnë shkallë të lartë të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale. Nuk ka asnjë të dhënë që gjyqtarja të ketë shkelur ndonjë prej atyre treguesve që lidhen me vlerësimin e etikës dhe të vlerave profesionale. Prandaj, propozimi është që për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” pikëzimi të jetë me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në lidhje me kriterin e katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, sa i përket “Komunikimit të qartë dhe transparent...”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, shkalla e aftësisë “e lartë”, pikëzimi 15 pikë.

Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, 15 pikë.

Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 10 pikë.

“Pjesëmarrja në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në 19 ditë trajnimi, pra brenda afateve të përcaktuara midis 15 dhe 120 ditë. Prandaj, propozohet pikëzimi maksimal me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, në projektraport propozohet pikëzimi me 3 pikë, për shkak se nuk ka pasur të dhëna.

Duke iu referuar kundërshtimeve të gjyqtares, ajo parashton që ka kontribuar me shumë përkushtim dhe profesionalizëm në përmirësimin e sistemit gjyqësor, pikërisht duke trajnuar magjistratët e rinj dhe studentët e Fakultetit të Drejtësisë. Në mbështet të kundërshtimeve gjyqtarja ka depozituar shkresën nr. {...} prot., datë 28.09.2016 të Shkollës së Magjistraturës, si dhe urdhrin nr. {...} prot., datë 03.11.2016 të Kryetarit të Gjykatës.

Referuar shkresës së Shkollës së Magjistraturës dhe shkresës së Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se gjyqtarja {...} ka udhëhequr kandidatë për magjistratë për kryerjen e praktikës para profesionale, për periudhën 03 tetor – 9 dhjetor 2016.

Në kushtet kur referuar akteve të paraqitura nga gjyqtarja, rezultojnë të dhëna që gjyqtarja të jetë angazhuar për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional, propozoj që gjyqtares t’i shtohen 2 pikë dhe të pikëzohet me 5 pikë për këtë tregues.

“Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave”, propozimi fillestar ishte për 3 pikë.

Në kundërshtimet e saj gjyqtarja ka parashtruar (po citoj):

“Me vendimin nr. 4, datë 13.12.2012, të Konferencës Gjyqësore Kombëtare, Mbledhja e Përgjithshme, jam zgjedhur Anëtare e Komisionit të përhershëm të Etikës, Verifikimit të Mandateve dhe të Përmirësimit të Vazhdueshëm Profesional.

Me vendimin nr. 47, datë 14.12.2015, të Konferencës Gjyqësore Kombëtare, Mbledhja e Përgjithshme, jam rizgjedhur Anëtare e Komisionit të përhershëm të Etikës, Verifikimit të Mandateve dhe të Përmirësimit të Vazhdueshëm Profesional.

Në datën 11 prill 2014, jam certifikuar për pjesëmarrjen time në “Trajnimi i Etikës Gjyqësore”, organizuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan USAID, OPDAT, dhe Ambasada Britanike. (Bashkëngjitur këtij materiali vë në dispozicion kopje të kësaj certifikate).

Vërtetim nr. 368, datë 17.05.2021, i Shkollës së Magjistraturës, (në 3 faqe) bazuar në të cilin rezultojnë të pasqyruara të gjitha seminarët trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të programit të formimit vazhdueshëm, në të cilat gjyqtarja ka marrë pjesë përgjatë periudhave përkatëse. Vërtetim të cilin e depozitoj në dosjen personale të gjyqtarit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Referuar akteve të depozituara nga gjyqtarja, dokumentet e sipërcituar, rezultojnë se gjyqtarja, në periudhën e vlerësimit 2013-2016 është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë, prandaj propozoj që të shtohen 2 pikë të tjera dhe për këtë tregues të pikëzohet me 5 pikë.

Sa i përket “Publikimeve ligjore akademike”, nuk rezultojnë që të ketë të dhëna, prandaj propozohet që të pikëzohet me 0 pikë.

Sa i përket kriterit të katërt “Aftësitë personale dhe angazhimit profesional”, nga 91 pikë që ishte propozimi fillestar, propozoj të shtohen edhe 4 pikë të tjera dhe gjyqtarja të vlerësohet me 95 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në total, vlerësimi i përgjithshëm, propozoj që nga 372 pikë që ishte vlerësimi fillestar, duke shtuar 4 pikë, të shkojë në 376 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit, zoti Muharemaj!



Atëherë fjalën e ka znj. {...}, shkurtimisht për situatat të cilat ju mendoni që nuk janë marrë në konsideratë nga relatori.

*{...}*: Faleminderit!

Shumë të nderuar, do ju kërkoja me shumë mirësjellje vetëm të them dy fjalë.

Sot e kam për nder që jam përpara jush. Është hera ime e parë që ndodhem përpara anëtarëve të Këshillit, në një mbledhje të tillë, kaq solemne. Kështu që, më besoni, është privilegj, është kënaqësi, por mbi të gjitha është përgjegjësi dhe emocion patjetër.

Teksa meditoja nëse duhej të isha sot këtu dhe duhet ta merrja këtë vendim, përtej çdo emocioni, përtej çdo përgjegjësie, sepse edhe ne gjyqtarët jemi njerëz si gjithë të tjerët, kemi edhe ne emocionet tona edhe pse dukemi shumë më të fortë përpara këtyre paneleve që drejtojmë çdo ditë, dhe ju ma besoni dhe ma kuptoni shumë mirë këtë gjë.

Mendova se mbi të gjitha është e rëndësishme që unë të ballafaqohem edhe të jem këtu, teksa ju merrni në shqyrtim pikërisht jetën dhe kontributin tim profesional, dhe duhet të jem gjithë sy e vesh për ta vlerësuar këtë moment dhe për t'ju thënë faleminderit të gjithë punës së kryer, gjithë punës tepër serioze, tepër voluminoze, dhe këtu marrë shkas ta falënderoj në veçanti relatorin, pasi jo vetëm ka bërë një punë shumë të detajuar por edhe relatoi në këtë seancë në detaje dhe pasqyroi edhe... Sinqerisht e falënderoj edhe një herë sepse citoi me saktësi dhe me precizion, jo vetëm konstatimet, rezultatet dhe konkluzionet e pasqyruara në këtë raport lidhur me periudhën e parë, edhe pse njësoj vlen për të dyja periudhat, por citoi me shumë korrektësi dhe në mënyrë të plotë dhe shumë të saktë edhe kundërshtimet që unë kam bërë me shkrim, të cilat unë i kam depozituar në mënyrë shumë të detajuar në datën 10 nëntor në Këshill, duke i bashkëngjitur atyre edhe provat që gjithashtu relatori i citoi shumë saktësisht.

Të them të drejtën, nuk dua të shtoj asgjë, nuk dua të kundërshtoj asgjë më shumë, nuk dua të thellohem në detaje përtej atyre që unë tashmë i kam pasqyruar me shkrim sepse jam e bindur që do të bija në përsëritje, do bëhesha e lodhshme, e mërzitshme për juve dhe nuk kam asnjë arsye ta bëj këtë. Unë dua vetëm t'ju them që ju e dini shumë mirë që prej disa vitesh ne ndodhemi në një situatë të vështirë dhe delikate, e cila ka

pasur shumë sfida për secilin prej nesh dhe kjo për shkaqe që nuk varen vetëm nga neve. Kështu që, unë do t'ju lutesha me shumë përlësi, me shumë mirësjellje, që në kuadër të këtij vlerësimi të merren në konsideratë dhe të merret në harmoni e gjithë performanca e gjyqtarës, gjithë figura dhe integriteti i saj, aq më tepër kur kemi të bëjmë me një punë jo pak vjeçare por plotë tashmë 15-vjeçare; dhe të merret si një entitet e gjithë performanca e saj e shfaqur, i gjithë personaliteti i treguar dhe i reflektuar apo i afektuar deri në këtë moment, bazuar patjetër, në evidencat dhe në të dhënat që janë pikërisht ato që janë të administruara në dosjen time personale. Kjo vlen lidhur me të dyja raport vlerësimet, si për periudhën e parë, ashtu edhe për vitin 2019.

Unë e kuptoj dhe jam shumë dakord që askush nuk është perfekt. Unë nuk jam sot këtu për t'ju thënë se gjithçka ka shkuar shkëlqyeshëm, por unë jam sot këtu vetëm për t'ju thënë, në mënyrë shumë të thjeshtë, shumë modeste, dhe shumë të sinqertë, se unë jam përpjekur dhe kam bërë maksimumin që kam mundur në çdo ditë timen, për të bërë më të mirën dhe për të dhënë mundësinë për t'u realizuar më e mira e mundshme. Vetëm, edhe një herë e theksoj, jo gjithçka varet nga sjellja jonë, nga performanca jonë, nga vullneti ynë.

Nëse më lejoni ju lutem, do doja vetëm dy momente shumë të shkurtra, që unë mendoj se janë të rëndësishme dhe do doja që të dëgjoheshin nga goja ime, pra nga zëri im. Sa i përket dy momenteve thelbësore që lidhen me dy rubrikat e para, për të cilat unë kam kundërshtimet e mia, nëse mund ta quaj kështu, pra “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” si dhe rubrika e dytë “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, në të gjithë raportin është shumë evidente që citohet dhe ricitohet, dhe shpjegohet vazhdimisht një punë shumë e mirë dhe një vlerësim shumë pozitiv i punës time profesionale ndër vite. Këtu është e padiskutueshme. Sikurse thuhet që, vendimet janë të sakta, janë të arsyetuara, janë pasojë e një rrjedhe logjike, ka një strukturë të qartë të organizuar, në mënyrë logjike. Janë të gjitha citime që janë në raport dhe unë nuk do doja që të përsërisja aspak askënd. Por arrihet edhe në një analizë ku sugjerohet apo konstatohet se mungon një analizë teorike, në kuptimin abstrakt të ligjit material apo atij procedural.

Unë dua shumë sinqerisht, të përsëris edhe një herë - janë gjëra që i kam thënë – lidhur me këto dosje dhe në veçanti lidhur me dosjet të cilat janë shortuar, pra jo ato të përzgjedhura nga unë, kanë koinciduar që kanë qenë gjykime (pra nuk kanë qenë zgjedhja ime, kanë qenë të tilla për koincidencë) që kanë zgjatur në maksimumin 1 ose 2 seanca. Kanë qenë gjykime që janë zhvilluar në formën e një gjykimi të shkurtuar, mbi aktet e prokurorit, me një fabul të ngjarjes krejtësisht të thjeshtë, krejtësisht të qartë, krejtësisht të saktë; akuza të provuara e të dokumentuara; nuk ka pasur asnjë lloj prapësimi, asnjë lloj pretendimi, asnjë problematikë të ngritur nga gjykimi nga secila prej palëve ndërgjyqëse, e çfarëdo lloji qoftë kjo, qoftë e natyrës materialo-penale apo procedurale. I pandehuri në këto raste, në të gjitha këto raste e ka pranuar akuzën penale, faktet, provat, cilësimin ligjor dhe të faktit penal si dhe është shfaqur i penduar. Vetë gjykata kryesisht nuk ka konstatuar ndonjë shkak procedural për t'u marrë në analizë të posaçme apo të veçantë nga ana e saj. Rrezikshmëria shoqërore e këtyre veprave (vlen edhe kjo për t'u theksuar), jo për t'i konsideruar gjykime më pak të rëndësishme, absolutisht asnjëherë nuk e them këtë, por natyra e veprave, natyra e veprimtarisë kriminale, nëse mund ta quaj kështu, rrezikshmëria që shfaqte autori i këtyre veprave në këto raste, ishte i një niveli tepër të ulët, aspak të lartë. Kështu që në këto raste, çfarë ka bërë gjykata? Gjykata ka shqyrtuar procedurën që ka ndjekur në këto gjykime, ka shpjeguar ato rrethana fakti sikurse janë parashtruar dhe vënë përpara saj; ka cituar dispozitat materiale, procedurale, kualifikimin ligjor; ka marrë në analizë katër elementët përbërës të ekzistencës së secilës prej këtyre veprave penale materiale; ka marrë në analizë të hollësishme të gjitha rrethanat personale, përkatëse që lidheshin me rrethana që ndikojnë në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, dhe ka qenë tepër e detajuar në këto rrethana; ka referuar saktë çdo dispozitë materiale procedurale penale të zbatuara në vendimmarrjen e saj.

Më lejoni t'ju them ju lutem, që në të tilla rrethana, gjyqtarja nuk ka pasur, nuk ka gjetur arsye konkrete dhe as interes në kuadër të zgjidhjes së çështjes dhe arsyetimit ligjor të saj, që të merrte në një trajtim më të hollësishëm faktet, apo një trajtim doktrinal lidhur me dispozitat materiale penale, sikurse ë rastin konkret kanë qenë nenet 137, 189, 199, 291 të Kodit Penal.

Unë mendoj se arsyetimi i një vendimi gjyqësor, përtej elementëve ligjorë të sanksionuar në ligj është një proces subjektiv dhe kreativ, që ndikohet nga rrethanat eventuale të çështjes, të cilat në vetvete e nxisin gjyqtarin në nevoja si dhe shkakun e bazuar në debat çfarë sjell si rrjedhojë trajtimin teorik të materies në shqyrtim.

Kështu edhe “frymëzimi” si element i rëndësishëm i anës subjektive në kuadër të arsyetimit ligjor, nxitet apo vihet në lëvizje nga disa mekanizma të brendshëm por që vihen dhe provokohen si të tillë gjithmonë nga çështjet që nxjerr vetë gjykimi dhe vetë debati gjyqësor, apo nga problematikat që qoftë edhe kryesisht gjykata arrin t’i shquaj apo t’i marri në shqyrtim.

Sa kohë që ka munguar një interes i ligjshëm në trajtimin doktrinal të këtyre dispozitave, gjykata thjesht nuk ka gjetur shkak për t’u investuar më tej. Ndaj unë mendoj që nuk mund të ketë një përcaktim determinant, pikërisht bazuar në të tilla raste apo duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana që po përpiqem t’i përsëris edhe një herë në mënyrë shumë të qartë përpara jush. Sikurse ka rezultuar, dhe ky fakt thuhet qartë po në projektraport, që në ato raste ku palët kanë pasur pretendime konkrete, në ato raste kur veprat penale kanë shfaqur një rrezikshmëri të shtuar shoqërore, në ato raste kur procesi është zhvilluar në formën e gjykimit të zakonshëm, ku të gjitha provat janë marrë një nga një përpara gjykatës, ka pasur ekspertime, ka pasur dëshmi (e të tjera me radhë si këto), gjykata i ka kushtuar vëmendje të hollësishme çdo detaji, qoftë të trajtimit doktrinal në aspektin material, ashtu edhe atij procedural. Pra dua të theksoj, kjo nuk ka qenë një neglizhencë apo një paaftësi e treguar e gjyqtarës, qoftë edhe në një rast të vetëm, por ka qenë nevoja dhe vëmendja e kushtuar në nivelin e duhur, në raport me rrethanat konkrete në shqyrtim. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak sesa kaq. Kështu që në këtë kuptim, madje unë mund t’ju sjell në vëmendje që të njëjtat konkluzione kanë arritur edhe në raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përgatitur po nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, depozituar gjithashtu edhe në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Kështu që unë do t’ju ftoja që edhe në këtë komunikim të drejtpërdrejtë, të sinqertë, do t’ju falënderoj për këtë, ju t’i merrni edhe një herë në vlerësim të gjitha këto detaje, të gjitha këto rrethana, të shprehura në mënyrë tepër dashamirëse dhe të sinqertë. Nuk heq asgjë nga ato që janë të shkruara në raport. Raporti

është i detajuar, është absolutisht një punë serioze, korrekte, dhe e pasqyruar gjithçka me një korrektësi absolute. Singerisht, falënderoj për këtë.

Nuk dua të bie në përsëritje. Nuk dua të bëj polemika. Nuk dua të bëj oponenca të panevojshme. Unë mendoj që çdo gjë është e shkruar e zeza mbi të bardhë (siç thotë edhe populli). Nuk dua të kontestoj, por unë mendoj që në projektraport thuhet shumë qartë edhe volumi i jashtëzakonshëm tej çdo niveli normal të imagjinuar që përballohet çdo ditë, jo vetëm nga unë, por nga shumica e kolegëve të mi, për të mos thënë nga të gjithë kolegët e mi, duke çuar pothuajse në një vetëmohim edhe të jetës sonë normale, familjare dhe shoqërore të përditshme.

Kështu që unë do t'ju lutesha që marrë në kontekstin e përgjithshëm, në mënyrën më objektive të mundshme, në proporcion me të gjitha rrethanat faktike (unë jam e sigurt që ju i dini këto dhe nuk kam asgjë të re për t'ju shpjeguar), duke kuptuar dhe në tërësi performancën time, gjithë kontributin që jam përpjekur në mënyrë të pandërprerë, të paktën që nga viti 2014 dhe në vijim, që nga fillimi i punës time në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Jam përpjekur që njëkohësisht të kryejë shumë detyra, me shumë përkushtim, me shumë devocion, qoftë të gjyqtares, qoftë të gjyqtares udhëheqëse, qoftë të gjyqtares që ka ndjekur dhe trajnuar të gjithë studentët e Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës dhe jo vetëm, vit pas viti, e ftuar edhe në auditorë, në leksione, madje e bërë kjo në mënyrë krejtësisht të vullnetshme vetëm për të bërë dhe për të dhënë kontributin tim sado modest, sado minimal, nuk ka rëndësi çfarë kam lënë; kam lënë diçka, por e kam bërë me kënaqësi dhe me dëshirë. Për të gjitha këto arsye, kjo ishte edhe arsyeja pse doja të isha sot këtu, që të gjitha këto t'i thosha me shumë përkushtim. Për të gjitha të tjerat, i qëndroj atyre që kam thënë në mënyrë të detajuar. Provat i kam paraqitur, edhe relatori i citoi dhe i pasqyroi me shumë korrektësi. Nuk mendoj se më mbetet diçka më shumë, se thjesht do bija në përsëritje dhe thjesht do isha edhe e lodhshme për ju, nuk dua ta bëj këtë.

Unë ju falënderoj, më besoni!

Ishte shumë kënaqësi.

*Naureda Llagami*: Shumë faleminderit zonja {...}!

Mund të vazhdoni për të lejuar Këshillin që të vijojë me miratimin...

{...}: Besoj që lidhur me raportin tjetër, nuk ka nevojë...

**Naureda Llagami:** Do ju ftojme prapë.

Pra mund të prisni përjashta. Të mbarojmë vlerësimin e raportit të parë dhe më pas, kur të fillojmë tek raporti i dytë, do të vini prapë që të dëgjoni relatorin.

{...}: Dakord.

Faleminderit!

*(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtarja {...}.)*

**Naureda Llagami:** Pasi dëgjuam edhe komentet e magistrates, kemi ndonjë diskutim nga relatori dhe më pas nga anëtarët?

**Erjon Muharremaj:** Nuk kam gjë tjetër për të shtuar. Përveçse doja të sqaroja që qëllimi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve është që t'i ndihmojë ata të reflektojnë në punën e tyre. Përveç kësaj shërben edhe si një bazë krahasimore, jo vetëm me gjyqtarët e tjerë, por në punën që ata bëjnë në vitet e mëpasshme. Në lidhje, veçanërisht me treguesit për të cilët gjyqtarja dha shpjegimet, konsiderohet një përmirësim i konsiderueshëm në vlerësimin e vitit 2019, duke qenë që unë jam relator edhe në atë vlerësim. Prandaj, vlerësoj që vlerësimi ka qenë objektiv.

**Naureda Llagami:** Edhe një gjë Erjon.

Te kush pikë propozuat rritje?

**Erjon Muharremaj:** Propozimi është që të ndryshohet pikëzimi në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, nga 3 në 5 pikë; dhe në treguesin

“Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave”, nga 3 në 5 pikë. Në total propozimi i ri është 376 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

**Naureda Llagami:** Pra nuk kemi ndryshim niveli.

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë propozim, koment, diskutime?

**Maksim Qoku:** Kam unë Kryetare!

Bazuar në atë çka u parashtrua nga relatori... (*shkëputet audio dhe nuk dëgjohet vijimi i fjalisë*), në grupkriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, ndarja A “Njohuritë ligjore”, nëndarja “b” “Aftësia për të interpretuar ligjin”, propozoj nga 20 në 25 pikë.

Po në këtë grupkriter, ndarja B “Arsyetimi ligjor”, nëndarja “c” “Cilësia e analizës dhe e argumentit logjik”, propozoj nga 20 në 25 pikë.

Gjithashtu, kam edhe një propozim tjetër, për sa i përket grupkriterit të dytë “Aftësitë organizative të gjyqtares”, në lidhje me ndarjen B “Aftësia e gjyqtares për të kryer procedura gjyqësore”, nëndarja “b” “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale”, propozoj vlerësimin maksimal nga 16 në 20 pikë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kemi propozime të tjera?

**Alban Toro:** Doja thjesht të theksoja ato që tha Maksi, të paktën për 2 nga këto kritere, për 1Ab dhe 1Bc, pra “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” dhe “Cilësia e analizës dhe e argumentit logjik”. Duke qenë që unë gjithmonë e konsideroj vendimin gjyqësor të dhënë nga gjyqtari si produkt individual dhe natyrisht ato shoqërohen me një farë dose subjektivizmi në vlerësim, gjithsesi kam konstatuar të paktën nga relatimi por edhe nga vendimet që ilustrojnë dhe ku është bazuar relatimi i vlerësimit, se gjyqtarja ka interpretuar ose interpreton në mënyrë të saktë dispozitën ligjore, duke i dhënë kuptimin e saktë asaj, duke analizuar elementët e figurës së veprës penale me detaje dhe natyrisht, kur ti identifikon në mënyrë të saktë veprën penale, kjo

mbështetet në një analizë, analizë të cilën ajo e ka bërë më duket në mënyrë të saktë, gjuha është e kuptueshme, qoftë edhe për një lexues mesatar. Kështu që ka pasur edhe pasurime me vendimet unifikuese apo të Gjykatës Kushtetuese, kështu që të gjithë këto indikatorë të tregojnë që është përpjekur që të japi më të mirën e mundshme, dhe bashkohem me atë që tha edhe Maksi për vlerësimin me plus 5 pikë për të dy kriteret (1Ab dhe 1Bc).

**Brikena Ukperaj:** Nëse s'ka dikush tjetër diskutim.

Lidhur me grupkriterin e parë që u propozua rritje në nivelin maksimal, në fakt gjyqtarja është vlerësuar "Shkëlqyeshëm" nga ana e relatorit pas një projektraporti vlerësimi shumë të detajuar. Unë këtu i kam të gjitha vendimet gjyqësore të gjyqtarës, si mendimet e zgjedhura, ashtu edhe vendimet e përzgjedhura me short.

Kam një pyetje për zotin Toro: Në cilin nga këto vendime konstatohet interpretim i dispozitës ligjore?

**Alban Toro:** Tek ato vendime që keni konstatuar edhe juve.

**Brikena Ukperaj:** Cili?

**Alban Toro:** Të kthehemi si pedagogu me nxënësin? S'e kuptoj këtë pjesën?!

**Brikena Ukperaj:** Problemi është që ne mbajmë një standard kur vlerësojmë gjyqtarët.

**Alban Toro:** Për ato standarde kam folur edhe unë vazhdimisht, që t'i ruajmë ato standarde.

**Brikena Ukperaj:** Në qoftë se do flasim në përgjithësi Alban...

**Alban Toro:** Hajde i marrim me radhë. T'i lexojmë vendimet edhe t'i shikojmë sepse unë nuk i kam marrë me vete këtu. I kisha lënë në zyrë.

**Brikena Ukperaj:** Unë i kam marrë vendimet, për t'i parë të gjitha vendimet.

**Alban Toro:** Hajde t'i lexojmë.

**Brikena Ukperaj:** Në qoftë se ju mendoni që kjo është shkalla më e lartë e zbërthimit të normës ligjore...



**Alban Toro:** Më duket se të thashë që shoqërohet me një dozë subjektivizmi dhe si e tillë secili ka opinionin e vet Brikena.

**Brikena Ukperaj:** Dëgjo Alban, nuk ka subjektivizëm.

**Alban Toro:** Për mendimin tënd nuk paska?!

A është produkt individual apo jo vendimi gjyqësor?

**Brikena Ukperaj:** Është.

**Alban Toro:** Si i tillë, subjektivizmin e ke brenda.

**Brikena Ukperaj:** Subjektivizmi do të ishte në rast se unë them që këtu shkalla e arsyetimit ose interpretimit të ligjit, më duket mua, që është “mbi mesatare” dhe vendos “mbi mesatare”. Jo! Subjektivizmi bazohet, sipas jush, në ca kritere shumë objektive që rezultojnë nga përshkrimi i dosjeve. Në qoftë se do t’i marrim të gjitha vendimet me radhë... sepse është një standard që ne e mbajmë në vlerësimin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”. Nuk varet fare aftësia e gjyqtarit për të interpretuar ligjin nëse çështja është e lehtë apo është e vështirë.

**Alban Toro:** S’ë përmenda këtë.

**Brikena Ukperaj:** Në qoftë se i marrim të gjitha vendimet gjyqësore (i heqim vendimet e përzgjedhura me short, janë vërtetë vendime që bëjnë fjalë për “Drejtim mjete pa dëshmi”, “Ndërtim pa leje” apo “Vjedhje energjie elektrike”), i referohemi vendimeve të përzgjedhura, një nga këto vendime të përzgjedhura është “Vrasje në rrethana cilësuese”, që bën fjalë për nenin 78 të Kodit Penal dhe “Armëmbajtjes pa leje”. Në qoftë se do ta shikojmë vendimin, nuk ka asnjë analizë të dispozitës më vete. Cilat janë elementët më vete të kësaj dispozite? Si qëndron kjo dispozitë më vete, krahasuar me armëmbajtjen pa leje dhe pse nuk janë marrë parasysh pretendimet e të pandehurit, i cili ka pretenduar pafajësi? Në qoftë se do të shikojmë vendimet gjyqësore, dominojnë në ¾ të tyre nga pjesa përshkruese e provave dhe jo analiza e provave. Këto nuk janë subjektive.

**Alban Toro:** Po elementët e figurës së veprës penale, a janë aty brenda?

**Brikena Ukperaj:** Në qoftë se ti mendon që një vendim gjyqësor duhet të ketë vetëm...

**Alban Toro:** Po një vepër penale çfarë ka brenda?

Ato analizohen më duket.

**Brikena Ukperaj:** Ato analizohen në përputhje me provat që ti ke marrë në shqyrtim.

**Alban Toro:** I ka cituar provat zonja?

**Brikena Ukperaj:** Provat thjesht evidentohen, nuk analizohen në drejtim të anës objektive, në shumicën e vendimeve. Nuk është vetëm qëndrimi që mbaj në këtë rast. Unë dua të ndalem sepse ky është qëndrimi që mbajmë ne në të gjitha rastet e vlerësimeve kur gjyqtarët janë vlerësuar në aftësinë “mbi mesatare”. Nuk është cilësia më e lartë e analizës së argumentimit logjik në këto vendime. Këtë dua të them.

**Alban Toro:** Ky është opinionin yt o Brikena dhe ta respektoj. Respekto të kundërtën tënde. Unë këtë opinion kam.

**Brikena Ukperaj:** Dua ta citoj që nuk ka subjektivizëm.

**Alban Toro:** Ka! Produkti individual ka gjithmonë brenda subjektivizëm.

**Brikena Ukperaj:** Sigurisht pra, por ka disa kriteret objektive.

**Marçela Shehu:** Albani thotë që ka subjektivizëm, ti thua që nuk ka subjektivizëm. Nuk mund të imponojmë njëri-tjetrit.

**Brikena Ukperaj:** Sigurisht! Por nuk mund të themi që meqenëse ka subjektivizëm dhe unë nga subjektivizmi...

**Marçela Shehu:** Ai ashtu e vlerëson.

**Brikena Ukperaj:** Ka disa kriteret objektive.

**Marçela Shehu:** Marrim përsipër të mësojmë kolegun dhe të korrigjojmë kolegun për atë që thotë apo marrim përsipër të japim mendimin tonë?

**Brikena Ukperaj:** Në qoftë se ne do të biem dakord që ky është standardi dhe unë nesër-pasnesër kur vlerësoj si vlerësuese do them që, për sa kohë Këshilli ka pranuar këtë standard, atëherë këtë do e quaj standardin më të mirë të arsyetimit ligjor të një vendimi.

**Alban Toro:** Standardi i Këshillit është shprehur me rregullore, metodologjinë që ti ke përpara. Si i tillë, ajo interpretohet nga gjithsecili prej nesh dhe që ka opinionin e vet. Kështu që respekto opinionin e kundërt.

**Brikena Ukperaj:** Dakord, unë e respektoj opinionin e kundërt.

**Alban Toro:** Mos më thuaj që nuk ka subjektivizëm pastaj.

**Brikena Ukperaj:** Jo, jo, nesër do shkruajmë raportin përfundimtar të vlerësimit dhe kur të shkruajmë këtë raportin përfundimtar të vlerësimit, relatori kur ta shkruajë, duhet patjetër që të evidentojë atë që Këshilli bie dakord.

**Alban Toro:** Relatori ka opinion e vet dhe është i detyruar të respektojë kornizën ligjore dhe rregullative.

**Brikena Ukperaj:** Ai që e shkruan raportin përfundimtar...

**Alban Toro:** Nuk ndikohet ai nga Këshilli?

**Brikena Ukperaj:** ...nesër-pasnesër duhet ta shikoj dhe duhet të them që, të gjitha këto, si do t'i përkthej në vlerësim maksimal? - meqenëse është subjektive.

**Alban Toro:** Ti do t'i përkthesh sipas bindjes tënde të brendshme dhe sipas akteve normative që ke për këtë pjesë. Unë kam opinionin tim mbi opinion tënd dhe do bëj oponencën time. Kaq. Shumë e thjeshtë. Nuk ke pse ta kthesh në standard mendimin kundërt të Albanit se mund të jetë pakicë dhe ka mundësi që votat të mos i marri. Unë këtë s'mund ta kthej në standard të Këshillit, se e thotë Albani.

**Brikena Ukperaj:** Po pra, por pikëzimi më i lartë nuk mund të argumentohet me faktin që thjeshtë është subjektive dhe unë e vlerësoj kështu.

**Alban Toro:** Nuk më duket se unë thashë që është vetëm subjektive, por “shoqërohet me doza subjektive”.

**Brikena Ukperaj:** Duhet të ketë. Domethënë ka bërë këtë gjë që relatori e ka cilësuar në mënyrë të gabuar kështu, por në fakt në vendime ekziston kështu.

**Alban Toro:** Ku e dëgjove këtë? Nuk e thashë askurrkund.

Pse keni maninë të interpretoni gjërat dhe t'i vendosni në gojën time kur s'i kam bërë apo kur s'i kam thënë? –se nuk është rasti i parë ky, ka edhe raste të tjera që i keni thënë dhe keni bërë sikur i kam thënë dhe i kam bërë unë.

**Brikena Ukperaj:** Cilat janë rastet?

**Alban Toro:** Ç'rëndësi ka, se nuk ka lidhje me faktin konkret.

Po të them, mund ta dëgjojmë nga fillimi çfarë kam thënë. “Shoqërohen me doza subjektivizmi”, do të thotë që secili në opinionin e vet ka një opinion të ndryshëm nga

tjetri, mjafton që të jetë i argumentuar. Unë argumentova për aq sa kisha mundësi. Vendimet e ilustruara... vetë raporti është pozitiv dhe shprehet pozitiv për pjesën e analizës, etj., dhe në këtë opinion them që të shtohen edhe 5 pikë. U bashkova me zotërinë... Por kjo nuk do të thotë që ta kthejmë në standard që Albani thotë kështu. Në qoftë se është në pakicë Albani, do të ngeli në pakicë. Kemi dëgjuar një mendim më tepër. Nuk më ngel hatri.

**Naureda Llagami:** Atëherë, vazhdojmë.

Lidhur me propozimin e parë, që kemi të bëjmë me rritjen e 5 pikëve tek “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, është propozim i ardhur nga Maksi dhe Albani.

Kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Kundër, me arsyetimin që kam bërë me cilësinë e relatorit edhe në projektraportin e vlerësimit edhe si reagim ndaj kundërshtimeve që paraqiti gjyqtarja në seancën dëgjimore.

**Brikena Ukperaj:** Kundër dhe dakord me konkluzionin e relatorit.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(Miratohet propozimi për t’iu shtuar 5 pikë këtij treguesi.)*

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek propozimi i dytë i ardhur po nga Maksi dhe Albani, që “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik” nga 20 pikë, propozimi është në 25 pikë.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Kundër, me të njëjtin arsyetim.

**Brikena Ukperaj:** Kundër, me arsyetimin e relatorit.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(Miratohet propozimi për t'iu shtuar 5 pikë këtij treguesi.)*

**Naureda Llagami:** Kalojmë në propozimin e Maksit “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e pushtetit gjyqësor”, nga 16 pikë, në 20 pikë.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Nuk i mori votat.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në propozimin e Erjonit për rritjen e pikëve tek “Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional”, nga 3 në 2 pikë *(duke iu shtuar 2 pikë)*.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(Miratohet propozimi i relatorit.)*

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek propozimi tjetër i Erjonit, “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe për veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, nga 3 në 2 pikë *(duke iu shtuar 2 pikë.)*

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(Miratohet propozimi i relatorit.)*

**Naureda Llagami:** Nuk ndryshon vlerësimi "Shkëlqyeshëm", ndryshojnë pikët në 390 pikë. Jemi dakord në tërësi? Pra vlerësimi "Shkëlqyeshëm", pikët 390.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.11.2021)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarës {...}, për vitin 2019, relator z. Erjon Muharremaj.<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 16:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

---

<sup>2</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e gjashta në rendin e ditës.



*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje për arsye familjare anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brunilda Kadi*, ndaj çështjet e parashikuara në rendin e ditës ku relatore është znj. Kadi, dalin nga rendi i ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
- 6. {...}, magjistrate.*

**RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për vitin 2019, relator z. Erjon Muharremaj.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek raporti i dytë.

Ftojme sërish magjistraten.

*(Futet në sallën e mbledhjes gjyqtarja {...}.)*

*Naureda Llagami:* Pa humbur kohë, fjala për ty Erjon sërish, për të prezantuar gjetjet e raportit.

*Erjon Muharremaj:* Faleminderit!

Sërish do të përqendrohem vetëm në ato pika për të cilat gjyqtarja ka kundërshtuar projektraportin e vlerësimit, për vitin 2019.

Sa i përket “Aftësive profesionale të gjyqtares”, siç referova edhe në diskutimin që bëra pak më parë, vërehet një ngritje nga ana profesionale e gjyqtares për vitin 2019, dhe propozimi është që për “Aftësitë profesionale” të pikëzohet në maksimum me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket “Respektimit të afateve ligjore”, rezulton që 72% e çështjeve të jenë jashtë afatit dhe për shkak të arsyeve që ju janë paraqitur në projektraport është propozuar, sipas Metodologjisë së Pikëzimit do duhet që të ishte pikëzuar me 3 pikë, por në fakt, propozimi është që të pikëzohet me 9 pikë, pavarësisht se ka gjykuar 72% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në projektraportin e vlerësimit është bërë analizë e detajuar e të dhënave statistikore, duke përjashtuar nga kjo përllogaritje matematikore çështjet të cilat mosrespektimi i afateve ligjore ka ardhur për shkak të shortimit me vonesë të çështjes apo çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër. Nga kjo përllogaritje është vlerësuar se vetëm 12 prej tyre kanë përfunduar tej afatit ligjor, nga 25 çështje që kanë afat ligjor të parashikuar për përfundimin e tyre, ose 48% jashtë afati ligjor.

Në projektraportin e vlerësimit nuk është bërë thjesht një llogaritje matematikore e çështjeve të përfunduara jashtë afateve ligjore, por është bërë një analizë logjike e të dhënave burimore, këtu duke pasuar parasysh edhe kohën relativisht të shkurtër të tejkalimit të afatit ligjor në shumicën e çështjeve të analizuara, në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja të pikëzohet me dy nivele më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, në referim kjo edhe të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja, ka depozituar kundërshtime duke parashtruar (citoj):

Ngarkesa tepër të madhe e përballuar nga gjyqtarja në gjykimin e çështjeve gjyqësore përgjatë vitit 2019, në total 715 çështje civile të gjykuara, të përfunduara, të arsyetuara e të dorëzuara brenda një afati rekord në sekretarinë e gjykatës,

Komandimet e një pas njëshme për gjykime në gjykata të tjera gjyqësore (nëpër rrethe të tjera, si Krujë, Kurbin, Elbasan), të caktuara me vendim nga KLGJ, në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë;

Ndërkohë gjyqtarja kryente edhe detyrën e gjyqtares udhëheqëse përgjatë praktikës profesionale dhe paraprofesionale të kandidatëve për gjyqtarë në kuadër të programit formues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe në të njëjtën kohë ka ndjekur edhe praktikën e studentëve të Fakultetit Juridik të Tiranës, në kuadër të vitit të tretë të studimeve “Bachelor”. Studenti përkatës është caktuar nga Kryetarja (në detyrë) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të kryer praktikën pranë gjyqtares {...}. Fakt i deklaruar nga ana e gjyqtares edhe në CV (curriculum vitae) të cilën e ka depozituar bashkëngjitur me kërkesën/aplikimin e bërë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në 2020;

Ndërkohë gjyqtarja ndiqte me rigorozitet trajnimet vazhduese, të detyrueshme, dhe shumë angazhime të tjera profesionale të cilat lidhen gjithashtu me performancën e saj shumë të lartë në punë;

Afatet, në disa prej çështjeve civile (themeli) me palë, nuk janë mundur të zbatohen plotësisht jo për shkak të veprimeve apo mos veprimeve të gjyqtares, por për shkak të sjelljeve të palëve në proces;

Pamundësisë së institucioneve për t’u përgjigjur në kohë procesit gjyqësor;

Në përmbushje me qëllimin kryesor “zhvillimin e një procesi të drejtë dhe të rregullt ligjor, si dhe zgjidhjen e çështjes bazuar në një hetim gjyqësor të plotë, të drejtë, objektiv, të gjithanshëm, shterues”, gjyqtares i është dashur të kryejë me korrektësi dhe profesionalizëm hetimin e plotë gjyqësor, si dhe shqyrtimin e çdo kërkesë të parashtruar nga palët ndërgjyqëse; rrethana këto të cilat kanë marrë kohën e tyre objektivisht të nevojshme dhe absolutisht të pashmangshme;

Këto fakte, tregojnë dhe pasqyrojnë shumë qartë përkushtimin, përpjekjet maksimale të pakushtëzuara, të gjyqtares në përballimin e ngarkesës në punë, në kushte dhe rrethana tepër të vështira, dhe aspak normale apo komode. Për të gjitha këto arsye mendoj që gjyqtarja duhet të vlerësohet maksimalisht edhe për këtë tregues, pikërisht edhe për shkak të gjithë këtyre rrethanave. Këto parashtrime i kam bërë të qarta dhe me

dije që në paraqitjen e Formularit të Integruar të vetë-vlerësimit profesional të depozituara me shkrim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.” – këtu përfundoj citimin.

Lidhur me parashtrimet e gjyqtares për vlerësimin maksimalisht për shkak të ngarkesës tepër të lartë të përballuar prej saj gjatë periudhës së vlerësimit, evidentohet se në projektraportin e vlerësimit është marrë në konsideratë kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtares dhe pikërisht për këto arsye është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet në nivelin “21-30%” duke e pikëzuar me 9 pikë, pavarësisht se referuar të dhëna statistikore, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 72% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Lidhur me parashtrimin se gjithashtu duhet të kihet në konsideratë dhe fakti që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit ka kryer edhe detyrën e gjyqtares udhëheqëse përgjatë praktikës profesionale, apo ndiqte me rigorozitet trajnimet vazhduese, të detyrueshme, dhe shumë angazhime të tjera profesionale, vlen të theksohet se këto të dhëna janë burim vlerësimi për tregues të tjerë, konkretisht në treguesin 4.C.b “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” dhe 4.C.a “Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraportin e vlerësimit.

Sa i përket “Plotësimi të standardeve minimale kohore”, shkalla e aftësisë “11-20%” dhe pikëzimi 4 pikë.

Sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” - Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht:

Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 233,5 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 44.3 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 173.5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në kundërshtimet e veta gjyqtarja ka parashtruar se lidhur me çështjet civile me palë, gjykime themeli shqyrtimi gjyqësor i të cilave ka një kompleksitet të shtuar, që lidhet me vetë sjelljen e palëve, njoftimet procedurale, sjelljen e palëve të treta, institucionet shtetërore, etj. si këto, çfarë në rrethanat konkrete nuk provohet se ka të bëjë aspak me “aftësitë organizative të vetë gjyqtarës”, por vetëm sa rrisin vështirësinë e saj në përballimin e këtyre proceseve gjyqësore.

Duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, vetëm për një kategori, tejkalohet vetëm për 1 muaj 23 ditë, si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja, vlerësoj se ky tregues duhet të vlerësohet në nivelin maksimal, pra propozoj shtimin me 1 pikë, nga 4 në 5 pikë për treguesin e “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”.

Sa i përket “Kohës mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” vlerësimi është që koha është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve - pikëzimi maksimal, 15 pikë.

“Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, “1-3 seanca” dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – pikëzimi maksimal, 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, 20 pikë.

“Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, 10 pikë.

Pra për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtares”, nga propozimi fillestar me 92 pikë, propozoj rritjen me 1 pikë dhe vlerësimin me 93 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket treguesit të “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” nuk ka asnjë të dhënë për cenimin e këtij treguesi, prandaj propozohet pikëzimi maksimal me 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit të “Aftësive personale dhe angazhimit profesional”, në lidhje me “Komunikimin e qartë dhe transparent...”, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, shkalla e aftësisë “e lartë”, pikëzimi 15 pikë.

Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 15 pikë.

Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi 10 pikë.

“Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në 8 ditë, pra brenda afateve të përcaktuara në Metodologjinë e Pikëzimit midis 5 dhe 40 ditë. Prandaj, propozohet pikëzimi maksimal me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional”, duke qenë që ka të dhëna propozohet pikëzimi me 5 pikë.

Sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, në kushtet kur nuk ka të dhëna propozimi fillestar është për 3 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet e saj, duke parashtruar se (citoj):

“Përgjatë vitit 2019, në cilësinë e Gjyqtares Udhëheqëse, kam ndjekur me shumë përkushtim dhe profesionalizëm praktikën profesionale të studentëve në vitin e fundit të studimeve Bachelor & Master, të cilët janë caktuar (në mënyrë të vazhdueshme) pranë meje me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nën rekomandimin dhe kërkesën e bërë nga Fakulteti i Drejtësisë – Universiteti i Tiranës, si dhe nga Universitete të tjera si Universiteti Europian i Tiranës, Universiteti Wisdom, etj. Ky fakt vërtetohet dhe dokumentohet edhe bazuar në Vërtetimin me Nr. Extra, datë 18.03.2021, lëshuar nga Zv/Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vërtetim të cilin e kam depozituar edhe më parë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Përgjatë vitit 2019, në kuadër të një marrëveshjeje të lidhur në mënyrë kontraktuale (pa pagesë) me Universitetin Europian të Tiranës, jam angazhuar në cilësinë e ekspertes në leksione/seminare të hapura, të organizuara në auditoret e këtij universiteti, duke kontribuar në kuadër të formimit të juristëve të rinj, student të fakultetit të drejtësisë, me qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë, por edhe në kuadër të një komunikimi publik të hapur (në auditor universitar) me qëllim informimin e publikut, lidhur me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës. Një marrëveshje kjo e cila vijon si e tillë me këtë universitet.

Bazuar në certifikatën e aftësisë së njohjes së gjuhës angleze, TOEIC, jam certifikuar me nivelin B1. Testimi i gjuhës angleze, i njohur ndërkombëtarisht. Testimi organizohet nga ETS (English Testing System) – organizata më e madhe në botë për testimin dhe vlerësimin e njohurive në gjuhën angleze. Kjo certifikatë është veçanërisht e vlefshme në mjediset e punës, në rang global.” – këtu përfundoj citimin.

Sa i përket kundërshtimeve të gjyqtares, në cilësinë e relatorit, konsideroj se asnjë nga veprimtaritë e paraqitura nga gjyqtarja nuk mund të klasifikohen si veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo në veprimtarinë për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Në këto kushte, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraportin e vlerësimit për vlerësimin me 3 pikë.

Sa i përket “Publikimeve ligjore akademike” nuk ka të dhëna, propozimi është për 0 pikë.

Në tërësi, për vlerësimin e përgjithshëm, nga 385 pikë që ishte propozimi fillestar, duke shtuar 1 pikë në grupkriterin e “Aftësive organizative të gjyqtares”, propozoj që vlerësimi i përgjithshëm të jetë 386 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit zoti Muharremaj!

Fjalën e ka magjistratja zonja {...}.

Shkurtimisht të lutem.

{...}: Faleminderit!

Sikurse u tha edhe në fjalën e relatorit, unë i kam parashtruar të gjitha kundërshtimet e mia edhe provat bazuar në të cilat unë i prapësoj dhe i mbështes prapësimet e mia. Do doja vetëm të sqaroja një detaj, duke mos dashur që të mbetem thjesht e keqkuptuar nga asnjëri nga ju, sa i përket rubrikës së parë të trajtuar në kuadër edhe të kundërshtimeve dhe prapësimeve të bëra nga ana ime, që lidhet me “Aftësitë organizative të gjyqtares” në përballimin e ngarkesës në punë, në momentin kur unë kam cituar në kundërshtimet e mia që kush kanë qenë rrethanat për shkak të të cilave janë humbur në shkaqe objektive koha gjyqësore dhe afatet e përcaktuara në ligj për t’u përfunduar këto gjykime, kam dashur të tregoj, pra kush kam cituar ndër të tjera, edhe kohën si gjyqtare udhëheqëse, etj.; nuk kam dashur t’i citoj si cilësi për t’u vlerësuar por kam dashur t’i citoj si angazhime të miat, në kuadër të të cilave është marrë koha përkatëse, e cila më ka vënë mua në një ngarkesë të shtuar, në kuadër të të gjithë angazhimit tim profesional. Pra vetëm kam dashur të kuptohet që e gjithë kjo ngarkesë pune dhe të gjitha këto angazhime, që kuptohet kanë vlerën e tyre në sistemin e pikëzimit, por në këtë moment të kuptohen si rrethana objektive të cilat kanë marrë kohën time, në kuadër të të gjithë ngarkesës, impenjimit dhe angazhimit tim profesional, si gjyqtare përgjatë gjithë vitit 2019.

Unë e kam theksuar, ngarkesa e punës ka qenë e frikshme në momente të caktuara, e megjithatë dua të ndalem vetëm në dy detaje që tregojnë qartësisht përkushtimin tim. Nuk ka një vonesë të vetme të konstatuar në dorëzimin dhe depozitimin e dosjeve në afat. Kjo tregon që për sa më ka takuar mua si gjyqtare, për sa



më ka takuar mua ta bëj edhe natën ditë kur ka qenë nevoja për të punuar dhe për të kapur afatet e mia procedurale, unë kam bërë dhe kam dhënë maksimumin tim, edhe në cilësi, edhe në afat, edhe me shërbim, në mënyrën më rigorozë dhe më ligjore të mundshme, me një përkushtim maksimal.

Pastaj, të gjitha të tjerat, sigurisht që do t'i vlerësoni dhe t'i shqyrtoni. Jam e sigurt, mjafton që të gjitha të merren në konsideratë dhe të jenë në proporcion performanca, të dhënat, gjykimi, cilësia, shpejtësia, kushtet, rrethanat, sikurse edhe ju i dini shumë mirë.

Ju thashë edhe qëparë, nuk jam duke ju thënë absolutisht asgjë të re. Jam e bindur që janë fakte dhe rrethana që ju i konstatoni çdo ditë në punën tuaj. Shumë faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

***Erjon Muharremaj:*** Kisha një pyetje, meqë keni paraqitur kundërshtime, sa i përket treguesit të “Pjesëmarrjes tuaj në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”. I qëndroni kundërshtimeve tuaja?

*{...}*: Patjetër! Të gjithave!

***Erjon Muharremaj:*** Në cilësinë e provës keni paraqitur aktmarrëveshjen me ekspertin e ftuar të lidhur me Universitetin European të Tiranës.

Po citoj aktmarrëveshjen: Sot në datën 03.07.2020 në Tiranë, në Selinë e Universitetit European të Tiranës, në adresën Bulevardi “Gjergj Fishta” lidhet sot kjo aktmarrëveshje ndërmjet (dhe janë palët). Ajo që më intereson për çështjen e vlerësimit është që thuhet “viti akademik 2019-2020”. Pra data është 03.07.2020, ndërkohë që ka përfunduar viti akademik. Sepse korriku është sezon provimesh. Thoni “viti akademik 2019-2020”.

{...}: Nuk e them unë. Ai është një material që konceptohet nga institucioni përkatës, pra nga pala përkatëse, dhe pasqyron një fakt në kuadër të një marrëdhënieje që ka zgjatur në një kohë të caktuar përgjatë vitit akademik 2019-2020, sikurse citohet aty. Pra nuk bëhet fjalë për një kontratë që fillon atë ditë. Nëse jam e qartë.

**Erjon Muharremaj:** E qartë!

{...}: Pra është për të konkretizuar këtë marrëdhënien time, për ta bërë të dokumentueshme këtë marrëdhënien time apo këtë kontribut timin. Sikurse, nëse mund të heq një paralele, sikurse ju nuk dispononi të dhëna lidhur me udhëheqjen time apo mentorimin që unë kam kryer në cilësinë e gjyqtares udhëheqëse gjatë periudhës 2014-2016, patjetër do më duhej të dokumentoja faktet dhe rrethanat, të cilat Këshilli, për arsye të caktuara nuk i disponon dhe nuk i ka si të dhëna. Kështu që ai është një dokument për t'ju sjellë dhe për t'ju bërë me dije dhe për ta konkretizuar pretendimin dhe faktin që unë parashtroj dhe pretendoj përpara jush.

**Erjon Muharremaj:** Në kundërshtimet tuaja ju shpreheni që është një veprimtari pa pagesë.

{...}: Po, pikërisht!

Sepse nuk është një veprimtari që unë shkoj, frekuentoj sa herë që ata kanë një diskutim, një auditor të hapur; ka një kërkesë të caktuar nga studentët për të diskutuar me një gjyqtar të Gjykatës së Tiranës lidhur me një problematikë të caktuar. Ata kanë disa gjyqtarë të cilëve iu bëjnë ftesa herë pas here, krejtësisht të vullnetshme, krejtësisht të lira dhe krejtësisht të papaguara. Në këtë kontekst ekziston edhe kjo marrëdhënie, nëse mund ta quaj marrëdhënie. Është më tepër kontribut. Nuk është as tamam marrëdhënie. Është një kontribut që unë kam dashur ta japë në mënyrë modeste. E thashë edhe pak më parë. Pra mos e konsideroni një marrëdhënie në vetvete juridike. Unë kam dashur që nëpërmjet atij dokumentacioni t'ju them që unë po relatoj një fakt të qenësishëm dhe nuk po krijoj një fakt hipotetik. Kjo është e gjitha.

**Erjon Muharremaj:** Në asnjë moment nuk u vu në dyshim angazhimi juaj.

{...}: Edhe unë, meqë më pyetët, ju sqarova. Nuk vë asgjë në diskutim.

**Erjon Muharremaj:** Kjo ka të bëjë me qëndrimin tim në cilësinë e relatorit, për shkak se nuk e kisha këtë informacion.

{...}: Ka qenë në dosje.

Ka qenë në dosje që në krye të herës. Megjithatë, unë jua plotësova edhe një herë në kundërshtime. Nuk ka asgjë të re sepse janë fakte të shumë viteve më parë. Kështu që, nuk kisha pse t'i fshihja dhe pse të mos i dokumentoja.

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Të bëj një pyetje për këtë veprimtarinë pa pagesë.

Zonja {...}, këtë veprimtari pa pagesë e keni pasur brenda orarit apo jashtë orarit zyrtar?

{...}: Në përfundimin e orarit zyrtar, pra pas orës 16:00.

**Brikena Ukperaj:** Sipas ligjit, ju keni detyrimin që për veprimtari jashtë (*ka shkëputje të audios dhe nuk dëgjohet e plotë fjala e znj. Ukperaj*) ... e keni bërë një njoftim të tillë lidhur me këtë veprimtari? Në qoftë se ka qenë në dosje. Është detyrim i ligjit për Statusin.

{...}: Faleminderit!

Unë kam vlerësuar që, në kushtet e një veprimtarie krejtësisht vullnetare, pa pagesë, jashtë orarit zyrtar dhe absolutisht në kuadër të një diskutimi të hapur dhe të lirë me studentët të cilët kanë pasur dëshirë të kenë një komunikim për të marrë disa njohuri bazike, të dëgjuara nga një gjyqtar, i cili mund t'iu japë një tjetër nivel të njohurisë së veprimtarisë së përditshme që kryhet nëpër gjykata apo nëpër procese të ndryshme gjyqësore, unë e kam konsideruar që nuk ka qenë e detyrueshme për mua kjo pjesë.

**Brikena Ukperaj:** Për ta raportuar në Këshill.

{...}: Për ta raportuar në Këshill. Nuk e kam bërë.

*(Merr fjalën për një pyetje edhe zonja Luli por pa ndezur mikrofonin.)*

*Në përgjigje*

*{...}*: Jo, jo, absolutisht!

Ka qenë, po themi, një herë në disa muaj; një herë në disa kohë, në kuadër të një interesimi të caktuar, në kuadër të një lënde të caktuar dhe pedagogu i lëndës, për të bërë më konkrete, më dinamike, më interesante, fton herë pas here...

*(Sërish zonja Luli merr fjalën pa ndezur mikrofonin dhe e pyet magistraten rreth marrëveshjes.)*

*Në përgjigje*

*{...}*: Jo, jo, absolutisht!

Marrëveshja është shumë e thjeshtë.

Në rast se unë marrë një ftesë të tillë, të cilës unë mundem t'i përgjigjem si kohë, aftësi dhe qoftë edhe vullnet për t'iu përgjigjur, unë mundet të shkojë dhe t'i përgjigjem. Kaq. Pra nuk është një detyrim që mua më varë, më cakton një kutikulë të caktuar, një orar të caktuar, një program të caktuar apo unë jam e detyruar që ta ndjek këtë. Besoj që edhe nga përmbajtja e dokumentit, mjafton që t'i hidhet një sy, kjo është shumë e qartë. Thjesht shprehet vullneti i palëve për të pasur një bashkëpunim të ndërsjellët ndërmjet njëri-tjetrit. Kaq

**Naureda Llagami:** Zonja {...}, shumë faleminderit për prezencën!

*{...}*: Edhe juve, shumë faleminderit!

Ishte kënaqësi edhe për mua.

Punë të mbarë dhe ju uroj shëndet të plotë, se kjo është shumë e rëndësishme sot.

Ditën e mirë!

*(Largohet nga salla gjyqtarja {...}.)*

**Erjon Muharremaj:** Kisha një propozim.

Tek "Aftësitë organizative të gjyqtares", nga 92 pikë që është propozimi fillestar, në treguesin "Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje", nga 4, të vlerësohet me 5 pikë. Pra në total 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm 386 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Tjetër?

Nëse nuk kemi tjetër, fillojmë me propozimin e Erjonit?

Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** (nuk dëgjohej vota).

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

(Miratohet propozimi i relatorit.)

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në tërësi raportin, me 386 pikë, niveli i vlerësimit të gjyqtares "Shkëlqyeshëm".

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Naureda Llagami:** Vazhdojmë me çështjet që kërkojnë dyer të mbyllura.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.11.2021)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}, relatore znj. Brikena Ukperaj.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 16:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje për arsye familjare anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brunilda Kadi**, ndaj çështjet e parashikuara në rendin e ditës ku relatore është znj. Kadi, dalin nga rendi i ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}, relatore znj. Brikena Ukperaj.

**Naureda Llagami:** Fillojmë me çështjen e radhës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllimi gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016. Relatore e këtij projekt-akti është zonja Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Lidhur me projektraportin e vlerësimit profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, pas administrimit të dosjes nga organet e rivlerësimit janë zhvilluar procedurat e mëtejshme në kuadër të këtij vlerësimi me grumbullimin e dosjeve të tjera të cilat janë burim vlerësimi, me grumbullimin e të dhënave arkivore pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe atyre që disponon Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe të gjitha burimet e vlerësimit janë të evidentuara në mënyrë analitike në raport.



Do të vijoj lidhur me vlerësimin referuar katër kritereve të vlerësimit.

Lidhur me kriterin e parë të vlerësimit “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, treguesi i “Njohurive ligjore”, propozoj pikëzimin me 25 pikë, pasi referuar të dhënave nga burimet e vlerësimit rezulton aftësi shumë e mirë në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve, identifikimin e normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim, identifikimin e natyrë së mosmarrëveshjes objekt gjykimi, analizës së detajuar të provave dhe e ligjit në vijim të arsyetimit të vendimit.

Lidhur me “Aftësinë e gjyqtarit për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, propozohet pikëzimi me 25 pikë, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, duke qenë se evidentohet se gjyqtari ka shumë aftësi të mira në interpretimin e të gjithë materialit procedural dhe në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes mbështet gjithmonë arsyetimin e vendimeve dhe zbaton praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë si dhe respekton parimet e së drejtës.

Lidhur me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, propozohet vlerësimi me 12 pikë, shkalla e aftësisë “mbi mesataren” sepse në vendimet gjyqësore evidentohet ruajtja e një ekuilibri midis pjesës përshkruese dhe asaj analitike duke i dhënë më shumë rëndësi kësaj të fundit. Pjesa analitike nuk është e zgjatur, është koncize dhe gjithëpërfshirëse, por nuk evidentohet e njëjta shkallë konciziteti, referuar pjesës përshkruese të vendimit. Ajo që konstatohet lehtësisht në mënyrën e të shkruarit të gjyqtarit është zgjatja e mendimit tek kjo pjesë, kryesisht e pasqyrimin të mendimeve të palëve. Këto të fundit, në shumicën e rasteve, nuk përmbledhen, madje disa herë pasqyrohen në vetën e parë. Kujdesi që gjyqtari tregon në pasqyrimin e të gjitha pretendimeve të palëve mbingarkon pjesën përshkruese të vendimit, me përsëritje faktesh apo rikthim në provat që janë pasqyruar një herë tek paraqitja e fakteve të çështjes. Gjyqtari duhet të tregojë aftësi në paraqitjen e përmbledhur të pretendimeve të palëve sepse gjithëpërfshirja dhe saktësia e paraqitjes së çdo pretendimi nuk nënkupton ricitim në vendim të të gjithë përmbajtjes së diskutimit përfundimtar të palëve. Theksimi i tepruar i hollësive dhe tendenca për të pasqyruar në vendim çdo diskutim të palëve, zbeh evidentimin e çështjeve që kanë përbërë thelbin e pretendimeve objekt padie apo prapësimeve në gjykim.

Referuar treguesit “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” propozohet vlerësimi me 10 pikë, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, sepse rezulton që gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse tij. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëorganizuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Referuar “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik” propozohet vlerësimi me 25 pikë, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, sepse rezulton që gjyqtari ka aftësi shumë të larta në mënyrën sesi ai e ndërton cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik sipas rregullit fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej vendimeve, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Përfundimisht, për kriterin e parë të “Aftësive profesionale” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" me 97 pikë.

Për sa i përket kriterit të dytë të “Aftësive organizative të gjyqtarit”, tek “Respektimi i afateve ligjore” nuk ka rezultuar, referuar burimeve të vlerësimit, asnjë çështje e gjykuar tej afatit ligjor. Ka qenë vetëm një çështje për të cilën parashikohej afat ligjor, i cili është respektuar, prandaj dhe propozohet pikëzimi me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej afatit ligjor është 0%.

Për sa i përket “Respektimit të standardit minimal” propozohet pikëzimi me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara tej këtij standardi është 0%. Të gjitha vendimet në dosjet e këqyrura të analizuara në kuadër të këtij procesi vlerësimi kanë qenë të përfunduara brenda standardeve minimale të zbatueshme sipas vendimit të ish-KLD.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, propozimi është 5 pikë, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, është bërë analiza dhe referuar rendimentit i cili rezulton në masën 89.85%, propozohet niveli i vlerësimit me 6 pikë. Nuk ka pasur nga unë si relatore propozim për të zbatuar një nivel më të lartë pikëzimi sepse rezulton që gjatë kësaj periudhe gjyqtari ka gjykuar pothuajse sa standardi sasior i përcaktuar. Nuk ka pasur ngarkesë të lartë në punë në mënyrë të tillë që mund të merret parasysh në një pikëzim më të lartë.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit”, propozoj pikëzimin me 15 pikë. Koha mesatare ka qenë më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Për sa i përket “Numrit mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, ka rezultuar që numri mesatar i seancave të jetë 2.6 seanca dhe gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj dhe propozohet pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, edhe në këtë rast është propozuar pikëzimi me 20 pikë, shkalla e aftësisë së gjyqtari “shumë e lartë”.

Për sa i përket rregullshmërisë dhe saktësisë së plotësisë së dokumentacionit të dosjes, edhe për këto dy tregues është propozuar pikëzimi maksimal.

Përfundimisht, për kriterin e “Aftësive organizative”, niveli i vlerësimit propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm" me 96 pikë.

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” nuk ka të dhëna që mund të flasin për cenim të etikës dhe integritetit, referuar edhe konkluzioneve të vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe për të gjithë treguesit e këtij kriteri është propozuar vlerësimi maksimal.

Përfundimisht për kriterin e “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikëzimi 100 pikë.

Për sa i përket “Aftësive personale dhe angazhimit profesional” është propozuar pikëzim maksimal për sa i përket “Komunikimit të qartë dhe transparent”, “Respektimit

të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, aftësisë së bashkëpunimit, shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët dhe me administratën gjyqësore.

Për sa i përket “Gatishmërisë së gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, për treguesin e “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës apo edhe në trajnime të tjera profesionale jashtë këtij programi”, është propozuar pikëzimi maksimal me 20 pikë sepse ka rezultuar që gjyqtari gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në 18 aktivitete të zhvilluara për 33 ditë plus 2 ditë trajnim jashtë këtij programi.

Për sa i përket “Disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk ka pasur të dhëna dhe për këtë tregues propozohet pikëzimi me 3 pikë, referuar Metodologjisë.

Për sa i përket “Angazhimit të gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale dhe përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” është propozuar pikëzimi me 5 pikë sepse rezulton angazhimi i gjyqtarit konkretisht nga të dhënat e dosjes personale dhe të dosjes së rivlerësimit, ka rezultuar që gjatë kësaj kohe, gjyqtari, me leje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka ushtruar veprimtari mësimdhënëse pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe në Universitetin jopublik “Albanian University”.

Për sa i përket treguesit të fundit që janë “Publikimet ligjore akademike”, nuk ka pasur të dhëna të cilat mund të çonin në një pikëzim prej 5 pikësh, prandaj është propozuar pikëzimi me 0 pikë.

Përfundimisht, për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" me pikët 93.

Mbasi është njohur me raportin e vlerësimit, gjyqtari ka paraqitur disa rezerva nëpërmjet e-mailit të cilat lidhen me rubrikën “Publikimet ligjore akademike”, duke sqaruar se pavarësisht se nuk e ka plotësuar dosjen e tij personale ai sjell në vëmendje të Këshillit që ka referuar në “The state, society and law: Regional Cooperation” – 23-24 maj, pranë Universitetit “Aleksandër Mojsiu”, Durrës dhe Albanian University dhe ka sjellë lidhur me këtë pretendim edhe një certifikatë e cila provon angazhimin e tij në këtë konferencë ndërkombëtare. Njëkohësisht pretendon që në bashkëpunim me Gjykatën e

Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Universitetin e Budapestit ka referuar së bashku me një magjistrat tjetër një temë “Ligji penal dhe zbatimi i tij”, në një konferencë tjetër ndërkombëtare.

Ndërkohë që gjyqtari ka shpjeguar se nëse provat dhe shpjegimet e tij vlerësohen relevante ai kërkon që ato të gjejnë pasqyrim në vlerësim, në rast të kundërt, në qoftë se Këshilli do të vlerësojë që janë të pamjaftueshme, ai është dakord me vlerësimin dhe pikëzimin e bërë.

Lidhur me pretendimet e gjyqtarit, në cilësinë e relatores, vlerësoj se ato nuk mund të merren në analizë në kuadër të publikimeve ligjore referuar parashikimeve të Metodologjisë, ku në këtë rast pikëzohen të gjithë gjyqtarët që kanë realizuar publikime në revista shkencore të cilat janë të pajisura me ... editorial, dhe referimet në konferencat ndërkombëtare janë tregues të cilët reflektojnë dhe duhet të afektojnë në kriterin e veprimtarive ndërinstitucionale dhe angazhimin e gjyqtarëve në këto veprimtari. Në kushtet kur pikëzimi për këtë tregues, referuar të dhënave të tjera është maksimal, thjesht këto dy prova të paraqitura nga gjyqtari do të evidentohen në projektraport si angazhime, por nuk sjellin ndryshim në nivelin e pikëzimit. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë gjë lidhur me projekt-raportin, ndonjë koment, propozim?

Nëse jo, kalojmë me votimin në tërësi të raportit të hartuar nga relatorja, sipas të cilit relatorja propozon që niveli i vlerësimit për zotën {...} është "Shkëlqyeshëm" dhe niveli i pikëve është 386 pikë. Jemi dakord?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.11.2021)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe shpalljen e kërkesës për kandidaturë”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro). *(Shtyrë nga mbledhja e datës 10 nëntor).*<sup>3</sup>

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 16:00.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Maksim Qoku</i>     | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i>       | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>6. Ilir Toska</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>          |

<sup>3</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta në rendin e ditës.

8. *Marçela Shehu* (anëtare)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje për arsye familjare anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brunilda Kadi*, ndaj çështjet e parashikuara në rendin e ditës ku relatore është *znj. Kadi*, dalin nga rendi i ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro). (Shtyrë nga mbledhja e datës 10 nëntor).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Për shkak të gjendjes së krijuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ku ekzistojnë disa pozicione të lira të përkohshme të lira, duke e konsideruar këtë gjykatë si



gjykatë në nevojë, KZHK e analizoi atë në funksion të adresimit të nevojave të këtyre problematikave.

Kështu, sipas Dekreti të Presidentit të Republikës nr.7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, kjo gjykatë formalisht duhet të kishte 6 gjyqtarë në organikë, efektivisht ushtrojnë funksionin vetëm 3, pasi zonja {...} aktualisht është komanduar pranë ILD-së, një tjetër është pezulluar me vendimin nr. 102, datë 28.10.2016, të ish-KLD-së, ndërsa gjyqtarja e tretë është pezulluar nga detyra për shkak të procedurave të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

Në formë tabelare ju kam paraqitur ngarkesën e secilit gjyqtar që ushtron funksionin efektivisht dhe mesatarisht i bie për secilin afërsisht 222 çështje të cilët ata kanë në ngarkim. Kështu që, duke pasur parasysh referencat e nenit 46, pika 1, të cilën për shkak të pozicioneve të lira e konsideron këtë si gjykatë nevojë, fakt i cili e cenon funksionin normal të saj, dhe faktit që të katërt gjyqtarët që janë tashmë të komanduar në skemën e delegimit, nuk kanë mundësi të ofrojnë ndihmë pranë kësaj gjykate, për shkak se ato janë caktuar pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm për të ndihmuar në normalizimin e funksionit të tyre, e vetmja skemë e cila mund të sjellë ndihmë dhe zgjidhje problemit që ka aktualisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për shkak të pozicioneve të lira të përhershme të cilat ekzistojnë, është skema e transferimit të përkohshëm me pëlqim.

Kështu që, bashkëlidhur këtij relacioni është bashkëlidhur projektvendimi përkatës, ku përcaktohet procedura dhe shpallja e kërkesës për kandidatura si dhe aktet të cilat gjyqtarët duhet të plotësojnë për t'u përfshirë në këtë skemë.

Në pikën 3 është lënë bosh përcaktimi i afatit të paraqitjes së kërkesave, pra depozitimit të tyre pranë KLGJ-së dhe ajo që unë sugjeroj si relator por edhe në kuadër të Komisionit, është data 03.12.2021. Pra është një afat optimal 10-ditor, ku gjyqtarët mund të njihen me këtë lloj shpalljeje, në mënyrë që të ofrojnë kandidaturat e tyre për të marrë pjesë. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, jeni dakord me projekt-aktin dhe me propozimin për lënien e afatit deri më datë 3 dhjetor 2021?

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Illir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura. Afati i paraqitjes së kërkesave për transferimin e përkohshëm është deri më datë 03.12.2021.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.11.2021)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Vlorë, z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.<sup>4</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 16:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>4</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta në rendin e ditës.

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje për arsye familjare anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brunilda Kadi**, ndaj çështjet e parashikuara në rendin e ditës ku relatores është znj. Kadi, dalin nga rendi i ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Vlorë, z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në aktin e radhës, që ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Vlorë, z. {...}. Për më shumë detaje, prapë fjalën ia jap zotit Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Më datë 17.11.2021 është depozituar një kërkesë me shkresë protokolluar me nr. {...} prot., nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit.

Rezulton se z. {...}, me vendim nr. 14, datë 21.12.1993 është emëruar ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Më pas, me vendim nr. 5, datë 01.07.1994 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Me dekretin nr. 8358, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

Si motiv të dorëheqjes, z. {...} ka parashtruar se: “Ka qenë një nder dhe privilegj i jashtëzakonshëm për mua, që të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Republikën e Shqipërisë, prej më shume së 28 vitesh. Kam pasur privilegjin të punoj prej vitesh në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier dhe së fundmi në Gjykatën e Apelit Vlorë. Tanimë , duhet të marr një vendim tepër të rëndësishëm profesional duke kërkuar dorëheqjen nga ky pozicion për arsye subjektive. Përkushtimi, me tepër ndaj familjes dhe heqja dorë nga problemet e përditshme, më kanë diktuar në marrjen e vendimit.” – pra, duke e bazuar këtë dorëheqje tek neni 65 i ligjit 96/2016.

Duke qenë se instituti i dorëheqjes bazohet tek vullneti i magjistratit dhe si i tillë nuk mund të kufizohet, dhe ky vullnet është materializuar nëpërmjet shkresës që ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kështu që në këto kushte, nga ana e relatorit, por edhe Komisionit është propozuar projektvendimi bashkëlidhur, në dispozitivin e të cilit do të gjeni: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Vlorë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.

Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.12.2021.

Të përjashtojë gjyqtarin z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën Apelit e Vlorë.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim, nëse nuk keni diskutime.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Vlorë, për shkak të dorëheqjes së tij.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.12.2021.

3. Të përjashtojë gjyqtarin z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.11.2021)*

***Pika 10 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për znj. {...}”, relator z.Medi Bici.<sup>5</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 16:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Naureda Llagami</i></b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>2. Maksim Qoku</i></b>     | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>3. Medi Bici</i></b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>4. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Dritan Hallunaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>6. Ilir Toska</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>8. Marçela Shehu</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>5</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 14-ta në rendin e ditës.

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje për arsye familjare anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Brunilda Kadi**, ndaj çështjet e parashikuara në rendin e ditës ku relatores është znj. Kadi, dalin nga rendi i ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për znj. {...}”, relator z.Medi Bici.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për znj. {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Bici.

**Medi Bici:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Zonja {...} ka rezultuar si kandidate fituese në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në profilin ndihmëse ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit, viti akademik 2021 – 2022. Në bazë të Vendimit nr.138, datë 02.04.2021, kandidatja është vlerësuar se plotësonte kriteret për të



marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2021 - 2022, profili ndihmëse ligjore.

Kandidatja ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe është përfshirë nga Shkolla e Magjistraturës, në listën e renditjes së kandidatëve fitues për vitin akademik 2021 – 2022.

Çështja ka ardhur në Këshill dhe është caktuar relatori (caktuar unë si relator) për verifikimin e procedurave të verifikimit, pasurisë dhe të integritetit të kandidates. Kur ishim në fund të verifikimeve, kandidatja, me shkresën e datës 04.11.2021, drejtuar Shkollës së Magjistraturës, Shkolla e Magjistraturës ka informuar Këshillin se znj.{...}, me kërkesën e saj, të depozituar më datë 01.11.2021, i është drejtuar Drejtorit të Shkollës dhe për dijeni Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka kërkuar heqjen dorë nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar. Sipas kësaj shkrese rezultoi se për këtë shkak, nga ana e Shkollës së Magjistraturës nuk është nënshkruar as marrëveshja e regjistrimit me znj. {...} në Shkollën e Magjistraturës, e cila ishte detyrim që të vazhdohej më tej.

Me heqjen dorë nga zonja {...} për të drejtën për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar dhe moslidhja nga ana e Shkollës së Magjistraturës të marrëveshjes së regjistrimit për këtë arsye, ka sjellë si pasojë rënien e shkakut për të cilin kjo procedurë ka filluar. Për këtë arsye vlerësohet se vijimi i saj nuk ekziston më. Znj. {...}, nuk ka më statusin e kandidatit fitues, status për shkak të të cilit ka filluar nga ana e Këshillit procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës. Për pasojë qëllimi i këtij procedimi është bërë i pamundur, çka sjell përfundimin e kësaj procedure pa vendim përfundimtar.

Për këtë, me vendim të Komisionit, në mbledhjen e Komisionit të Planifikimit Strategjik të datës 18.11.2021, u procedua që çështja t'i kalohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, në seancën plenare, për të deklaruar të përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, për znj. {...}.

Krahas kësaj, Komisioni ka përgatitur edhe projektvendimin përkatës i cili është i strukturuar në tre pika. Faleminderit, zonja Kryetare!

*Naureda Llagami*: Faleminderit, zoti Bici!

Keni ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të znj.{...}, të filluar me vendimin nr.217, datë 26.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidates fituese për ndihmëse ligjore, në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022.

2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet znj.{...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.11.2021)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e motoçikletave në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.<sup>6</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 16:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>6</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta në rendin e ditës.

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje për arsye familjare anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brunilda Kadi**, ndaj çështjet e parashikuara në rendin e ditës ku relatore është znj. Kadi, dalin nga rendi i ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.**
- 3. Luljeta Laze, Drejtore pranë Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e motoçikletave në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me transferimin e motoçikletave në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës, projekt-akt i cili është hartuar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më shumë detaje, në fakt nëse keni edhe pyetje, janë specialistët, është zonja Laze këtu e cila do të informojë lidhur me nevojën e miratimit të këtij projekt-akti.

**Luljeta Laze:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Në zbatim të akteve për miradministrimin e aseteve është përgatitur relacioni për shpërndarjen e motoçikletave. Për më tepër shpjegoj se me Vendimin nr. 652, datë 29.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është bërë detajimi i fondeve buxhetore për vitin 2021. Në këtë detajim është përcaktuar fondi prej 1,400 mijë lekë për blerjen e motoçikletave për përdorim nga ftuesit e gjykatës, sipas kërkesave që kishin paraqitur Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës.

Në mënyrë më të detajuar, situata aktuale mbi gjendjen e motoçikletave në këto dy gjykata është:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka aktualisht 6 copë motoçikleta në përdorim, të blera në vitin 2018. Kërkesa e kësaj gjykate për vitin 2021 për 7 motoçikleta të tjera, justifikohet me numrin e lartë të ftuesve që kjo gjykatë, 23 ftues gjyqësorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës kishte 1 motoçiklete prodhim i vitit 2005, e cila, ishte në gjendje të keqe teknike. Për këtë motoçiklete, KLGJ me vendim Nr. 502 datë 25.10.2021, miratoi nxjerrjen jashtë përdorimi të saj. Aktualisht kjo gjykatë nuk ka një motoçikletë në përdorim, megjithëse ka 4 ftues.

Në datën 5.11.2021, sipas parashikimeve të bëra nga detajimi i fondeve që thashë me vendimin nr. 652, pranë ambienteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor u bë dorëzimi i 9 motoçikletave dhe për sa më sipër, bazuar tërësisht në kërkesat e bëra dhe në fondin detajuar, propozojmë shpërndarjen e motoçikletave: 7 copë për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 2 copë për Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nëse ka ndonjë pyetje.

**Naureda Llagami:** Faleminderit Luli!

Ftoj kolegët nëse kanë pyetje.

Nëse jo, atëherë kalojmë në miratimin e projekt-aktit. Pra ftoj kolegët për miratimin e tij.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Transferimin e 7 (shtatë) motoçikletave, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Transferimin e 2 (dy) motoçikletave, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

3. Me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.11.2021)*

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave: 13.10.2021, 19.10.2021.<sup>7</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 16:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>7</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 15-ta në rendin e ditës.

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje për arsye familjare anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brunilda Kadi*, ndaj çështjet e parashikuara në rendin e ditës ku relatore është *znj. Kadi*, dalin nga rendi i ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave: 13.10.2021, 19.10.2021.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e fundit i cili ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve respektive 13 tetor dhe 19 tetor 2021.

Pasi nga ana e administratës ju janë vënë në dispozicion procesverbalet e përmbledhura, nga ana juaj nuk kemi ndonjë diskutim mbi to, kështu që unë ju ftoj që t'i miratojmë.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.



***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 13.10.2021 dhe 19.10.2021.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këtë projekt-akt po mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**